

DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA
E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË
KOSOVËS

RAPORTI I VITIT 2024



DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës u krijuan në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës, një amendamenti kushtetues dhe Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Ato janë të përkohshme dhe me mandat dhe juridiksion të përcaktuar për krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera të përkufizuara sipas ligjeve të Kosovës, të cilat pretendohen se kanë filluar të kryhen apo janë kryer në Kosovë nga 1 janari i vitit 1998 deri më 31 dhjetor të vitit 2000 nga, apo kundër qytetarëve të Kosovës, apo të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës kanë një seli në Hagë, Holandë. Personeli i tyre që përfshin edhe gjykatësit, Prokurorin e Specializuar dhe Administratoren, është ndërkombëtar.

**DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA
E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË
KOSOVËS**

RAPORTI I VITIT 2024



**DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS**

Përmbajtja

DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS	04
Parathënie	06
Një vështrim i shpejtë mbi DHSK-në	08
DHOMAT	22
1. Aktivitetet Gjyqësore	23
2. Aktivitetet e Kryetares dhe Gjykatësve	34
3. Aktivitetet e jashtme	37
MARRËDHËNIET ME JASHTË	38
ZYRA ADMINISTRATIVE	42
1. Kabineti i Administratores	44
2. Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun	46
2.1 Mediat	47
2.2 Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim	48
2.3 Bash këpunimi me shoqërinë civile dhe Rrjetin e Informimit të Gjykatës	49
2.4 DHSK-ja në internet	50
3. Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore	52
3.1 Njësia e Administrimit të Gjykatës	52
3.2 Njësia e Përkthimit	53
3.3 Zyra e Mbrojtjes	54

3.4	Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave	55
3.5	Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve	56
3.6	Njësia e Paraburgimit	57
4.	Seksioni i Administratës	58
4.1	Njësia e Burimeve Njerëzore	58
4.2	Njësia e Teknologisë së Informacionit	62
4.3	Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme	62
4.4	Njësia e Sigurisë	63
4.5	Njësia e Financave dhe Buxhetit	64
4.6	Njësia e Prokurimit	65
5.	Auditimi i Brendshëm	66
	INTEGRIMI I PERSPEKTIVËS GJINORE NË DHSK DHE ZPS	68
1.	Trajnimi për Integrimin e Perspektivës Gjinore dhe Kundër Ngacmimeve	69
2.	Personi i Kontaktit për Çështje Gjinore	72

AVOKATI I POPULLIT I DOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS 74

ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR	77
Parathënie	78
Mandati dhe Hetimet e ZPS-së	79
Zbatimi i Mandatit	80
Kuadri Udhëheqës i Prokurorisë	86
Ekipet e Prokurorisë	89

DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

Kemi kënaqësinë e veçantë t'ju paraqesim raportin vjetor të vitit 2024 të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK). DHSK-ja ka vazhduar me efikasitet dhe efektivitet përmbushjen e mandatit duke arritur një numër objektivash të rëndësishme gjatë vitit. U përfundua një prej çështjeve gjyqësore për krime lufte, u lëshua aktgjykimi në një çështje tjetër gjyqësore për krime lufte dhe iu përcoll trupit gjykues një çështje që kishte lidhje me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë. Janë duke u zhvilluar procese të tjera lidhur me hetimet për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë që kanë çuar në tri arrestime. Pas konfirmimit të aktakuzave kundër pesë të akuzuarve për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, u bënë tre arrestime dhe filluan procedurat paraprake. Procesi i çështjes më të madhe të krimeve të luftës dhe veprave penale kundër njerëzimit po përparon në mënyrë të efektshme. Së fundi, dy personat e parë të dënuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë i kryen dënimet e tyre, duke e mbyllur këtë çështje. DHSK-ja ka qenë në gjendje t'i zhvillojë proceset në mënyrë të organizuar dhe efektive në sajë të përkushtimit të palëkundur dhe profesionalizmit të gjykatësve të DHSK-së, anëtarëve të personelit dhe punonjësve të tjerë të gjykatës.

Veprimtaritë gjyqësore të DHSK-së u intensifikuan edhe më tej gjatë vitit 2024. Konkretisht, një çështje e lidhur me krime lufte arriti fazën përfundimtare me dhënien e aktgjykimit të formës së prerë dhe një dënim me burgim të ndryshuar. Aktgjykimi është dhënë në çështjen e dytë për krime lufte dhe ka filluar procedura e apelit. Gjykatësja e Procedurës Paraprake i përcolli trupit gjykues një çështje të tretë me tre të akuzuar në lidhje me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë. Përpara fillimit të gjykimit të tre të akuzuarit arritën marrëveshje për pranimin e fajësisë. Janë duke u zhvilluar procedurat gjyqësore në lidhje me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë ndaj pesë të akuzuarve. Procesi gjyqësor në çështjen më të madhe në lidhje me krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit është duke përparuar dukshëm, teksa ZPS-ja pritet të mbyllë paraqitjen e argumenteve të saj në prill 2025. Së fundi, dy personat e parë të dënuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë e përfunduan dënimin e tyre, duke e mbyllur kështu këtë çështje.

Trupat gjykues në të gjitha nivelet e procesit shqyrtuan aspekte të ndryshme, konkretisht, Gjykatësi i Vetëm, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, të dy Trupat Gjykues, Panelet e Gjykatës së Apelit, Paneli i Gjykatës Supreme, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese dhe Kryetarja.

Në mars të vitit 2024, gjykatësit e DHSK-së mbajtën plenaren e tyre vjetore gjatë të cilës u përditësuan me aspekte të rëndësishme institucionale dhe morën pjesë në diskutimin e temave të ndryshme të agjendës së seancës plenare. Gjykatësit u takuan përsëri në dhjetor për një seminar në të cilin bashkëbiseduan me të ftuar të ndryshëm për tema të rëndësishme të së drejtës penale ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2024, DHSK-ja vazhdoi bashkëpunimin me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE) dhe me shtetet e treta Kontribuuese. Bashkëpunimi dypalësh me shtetet ka rëndësi jetike për aftësinë e DHSK-së që të përmbushë mandatin e vet dhe ne kemi vazhduar të theksojmë në çdo takim diplomatik rëndësinë e finalizimit të marrëveshjeve për zbatimin e dënimeve për personat e dënuar nga DHSK-ja.

Në tetor, Kryetarja vizitoi Kosovën ku u takua me palët e interesuara, si dhe me Ministren e Drejtësisë së Kosovës, për t'i informuar ata për natyrën gjithmonë të hapur ndaj publikut të punës së gjykatës. Në nëntor Kryetarja organizoi takime në internet me anëtarë të shoqërisë civile dhe medias në Kosovë, ku iu dha informacion për veprimtaritë e DHSK-së dhe iu krijoi mundësinë të pyesnin për gjithçka që ishin të interesuar në lidhje me veprimtarinë publike të gjykatës.

Ekipi i komunikimit dhe ndërgjegjësimit ka vazhduar të organizojë një larmi veprimtarish në Kosovë me pjesëmarrës nga më të ndryshmit. Në tetor, DHSK-ja organizoi në Prishtinë një punëtori për Rrjetin e Informimit të Gjykatës (RRIGJ) ku anëtarët e RRIGJ-së bënë komente shumë të vlefshme për përmbajtjen dhe efektivitetin e programit të komunikimit dhe ndërgjegjësimit. Në dhjetor, Administratorja u takua përmes internetit me anëtarë të RRIGJ-së për t'i përditësuar mbi zhvillimet më të fundit gjyqësore. Programi i plotë i komunikimit dhe ndërgjegjësimit të DHSK-së u mundësua në sajë të ndihmës së vazhdueshme të pakursyer financiare të Zvicrës.

Proceset gjyqësore të DHSK-së mund të ndiqen duke vizituar galerinë publike dhe në internet. Konkretisht, DHSK-ja transmeton drejtpërdrejt proceset e saj gjyqësore në faqen e saj të internetit. Seancat mund të ndiqen gjithashtu edhe përmes kanalit të saj në YouTube. Përditësimet më të rëndësishme pasqyrohen në faqen e rrjetit të DHSK-së, në funksionin "LiveUpdate" (Përditësim i drejtpërdrejtë), si edhe në llogarinë në X të DHSK-së. Anëtarët e Njësisë së Informimit dhe Komunikimit me Publikun të DHSK-së organizuan seanca javore të informimit në internet gjatë të cilave dhanë informacion të përditësuar për proceset e DHSK-së dhe iu përgjigjën pyetjeve për veprimtaritë e gjykatës. Gjithashtu, në shtator 2024, DHSK-ja hapi dyert për publikun në kuadrin e Ditës së Vizitave për Paqe dhe Drejtësi, duke përfshirë edhe vizita në sallën e gjyqit.

I jemi jashtëzakonisht mirënjohës shtetit pritës, Holandës, për përkushtimin e tyre të paepur ndaj mandatit të DHSK-së dhe ndihmën e paçmuar që kanë dhënë gjatë gjithë vitit. Gjithashtu vlerësojmë shumë mbështetjen e palëkundur që shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuuese i kanë dhënë DHSK-së gjatë vitit 2024. Po kështu i jemi mirënjohës Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë për mbështetjen e dhënë gjatë operacioneve të kryera atje, si dhe Policisë së Kosovës për ndihmën e saj.

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare e Dhomave të Specializuara të Kosovës

Hagë, dhjetor 2024

Njëkohësisht u shprehim mirënjohje homologëve të DHSK-së në Shërbimin e Jashtëm të BE-së, në Shërbimin e Komisionit Evropian për Instrumentet e Politikës së Jashtme dhe Zyrën e Kapaciteteve për Planifikim dhe Drejtim Civil, për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre me DHSK-në gjatë vitit 2024.

Po kështu, u jemi mirënjohës shteteve, trupit diplomatik dhe gjykatave ndërkombëtare e të ndërkombëtarizuara në Hagë dhe organizatave joqeveritare në fushën e drejtësisë ndërkombëtare për shkëmbimet konstruktive në çështje organizative e administrative.

Mirëpresim vitin që kemi përpara, në të cilin DHSK-ja do të vazhdojë t'i kryejë proceset në mënyrë të sigurt, të pavarur, të paanshme, të drejtë dhe efikase, në përputhje me mandatin e saj.

Dr. Fidelma Donlon
Administratore e Dhomave të Specializuara të Kosovës

Një vështrim i shpejtë mbi DHSK-në

Në qershor të vitit 2008, Komisioni i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut emëroi një raportues të posaçëm për hetimin e pretendimeve për krime të rënda të kryera gjatë dhe menjëherë pas konfliktit të viteve 1998-1999 në Kosovë.

Në janar 2011, me Rezolutën 1782 (2011), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi raportin e përgatitur nga raportuesi i posaçëm (Raporti i Këshillit të Evropës) në të cilin pretendohet se ishin kryer krime të shumta kundër serbëve, shqiptarëve të Kosovës të dyshuar si bashkëpunëtorë, si dhe kundër personave të tjerë.

Në vijim të Raportit të Këshillit të Evropës, në maj 2011, shtetet anëtare të BE-së e shqyrtuan çështjen në kuadër të Komisionit Politik dhe të Sigurisë – organi që merret me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian. Pas kësaj u themelua Task Forca Hetimore Speciale (TFHS), e cila u ngarkua me detyrën e kryerjes së hetimeve të pavarura të pretendimeve për ndalim të paligjshëm, dënim, akte çnjerëzore, torturë dhe vrasje, si dhe për krime të tjera që lidhen me Raportin e Këshillit të Evropës. Me seli në Bruksel, TFHS- a filloi punën në shtator 2011.

Ndërkohë që vazhdonin hetimet, përmes Shkëmbimit të Letrave midis Presidentes së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë, në prill 2014, u arrit një marrëveshje ndërkombëtare për themelimin dhe funksionimin e dhomave të veçanta gjyqësore për ndjekjen penale të krimeve që mund të rezultonin nga hetimet e TFHS-së.

Shkëmbimi i Letrave përcakton se këto dhoma të dedikuara dhe të veçanta gjyqësore do të themeloheshin në përputhje me legjislacionin e Kosovës. Këto dhoma gjyqësore dhe zyra e prokurorit të specializuar do të kishin statutin dhe rregulloren e tyre të procedurës dhe provave, do të përbëheshin vetëm nga punonjës dhe drejtues ndërkombëtarë dhe do të kishin vetëm gjykatës ndërkombëtarë.

Në Shkëmbimin e Letrave thuhet gjithashtu se këto dhoma të veçanta gjyqësore do të kishin seli në një

shtet të tretë dhe se procedurat e ndjeshme, duke përfshirë dëgjimin e dëshmitarëve, do të mbaheshin jashtë Kosovës. Shkëmbimi i Letrave u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës me dy të tretat e votave në prill 2014 dhe u bë pjesë e legjislacionit të brendshëm. Ai ka përparësi ndaj ligjeve të Kosovës.

2014

Në korrik 2014, kryeprokurori i TFHS-së bëri një deklaratë në të cilën thuhej se TFHS-ja “do të jetë në gjendje të ngrejë aktakuzë ndaj disa zyrtarëve të lartë të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”

2015

Në mars 2015, Kryetari i Kuvendit të Kosovës i referoi Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ndryshimin kushtetues të propozuar nga Qeveria e Kosovës për zbatimin e Shkëmbimit të Letrave. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e Kosovës duhej të vlerësonte nëse ndryshimi i propozuar pakëson ndonjë prej të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kapitulli II i Kushtetutës.

Në prill 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës shpalli se ndryshimi i propozuar ishte në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe se “struktura, fushëveprimi i juridiksionit dhe funksionimi i dhomave të Specializuara do të rregullohen me ligje të mëtejshme, në përputhje me Kushtetutën”.

Ky ndryshim hyri në fuqi me anë të nenit 162 të Kushtetutës së Kosovës, që u miratua nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015. Në të njëjtën kohë u miratua edhe Ligji për themelimin e dy institucioneve, që është instrumenti themeltar i Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS).

2016

Në prill 2016, dr. Fidelma Donlon u emërua Administratore e Dhomave të Specializuara, duke shënuar kështu fillimin e punës së Zyrës Administrative të DHSK-së në Hagë.

Në **shtator 2016**, z. Dejvid Shvendiman u emërua Prokuror i Specializuar.

Më **dhjetor 2016**, gjykatëse Ekaterina Trendafilova u emërua Kryetare e DHSK-së. Ajo filloi punën në janar 2017.

2017

Më **1 janar 2017**, hyri në fuqi Marrëveshja me Shtetin Pritës midis Kosovës dhe Holandës, që i mundëson DHSK-së kryerjen e procedurave penale në territorin e Holandës.

Pas kësaj, në **shkurt 2017**, u emëruan nëntëmbëdhjetë gjykatës në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës. Në **mars 2017**, në plenaren e parë, gjykatësit e DHSK-së miratuan Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.

Pas vlerësimit të kushtetutshmërisë së saj nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, Rregullorja e Procedurës dhe e Provave hyri në fuqi në **korrik 2017**, duke e bërë DHSK-në plotësisht funksionale në aspektin gjyqësor.

Në **nëntor 2017**, Administratorja miratoi Direktivën për Mbrojtësit, e cila, ndër të tjera, përcakton kriteret e përzgjedhjes së mbrojtësve për përfaqësimin e të dyshuarve, të akuzuarve dhe viktimave në DHSK. Që atëherë, 241 avokatë nga Kosova, Serbia dhe një numër vendesh të tjera, janë pranuar në Listën e Mbrojtësve të Specializuar dhe Mbrojtësve të Viktimave.

2018

Në **maj 2018**, z. Pietro Spera u emërua Avokat i Popullit i DHSK-së.

Në **qershor 2018**, u ngrit Rrjeti i Informimit të Gjykatës, në të cilin bëjnë pjesë OJQ vendore nga Kosova dhe Serbia.

Në **shtator 2018**, pas z. Dejvid Shvendiman, në postin e Prokurorit të Specializuar u emërua z. Xhek Smith.

2019

Në **mars 2019**, gjykatësit e DHSK-së mbajtën plenaren e katërt. Në të njëjtin muaj, u miratua Kodi i Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para DHSK-së.

Në **qershor 2019**, DHSK-ja dhe ZPS-ja u zhvendosën në zyrat e reja në Hagë.

2020

Në **shkurt** dhe **prill 2020**, Prokurori i Specializuar paraqiti aktakuzat e para.

Në **prill 2020**, Administratorja Fidelma Donlon u riemërua edhe për një mandat katërvjeçar.

Në **shtator 2020**, bënë betimin gjashtë gjykatës të rinj, Prokurori i Specializuar arrestoi të akuzuarin e parë, z. Salih Mustafa, mbi bazën e akuzave për krime lufte, si dhe z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Në **nëntor 2020**, Prokurori i Specializuar arrestoi z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi mbi bazën e akuzave për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte.

Në **dhjetor 2020**, Kryetarja Ekaterina Trendafilova u riemërua për një mandat katërvjeçar.

2021

Më **16 mars 2021**, z. Pjetër Shala u arrestua në Belgjikë dhe më **15 prill 2021** u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së.

Më **5 maj 2021**, Kryetarja caktoi Trupin Gjyqësor I për çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës dhe gjykimi filloi më **15 shtator 2021** me deklaratën hyrëse të Prokurorit të Specializuar.

Më 15 korrik 2021, Kryetarja caktoi Trupin Gjykses II në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt* dhe gjykimi filloi më 7 tetor 2021 me deklaratën hyrëse të Prokurorit të Specializuar.

2022

Më 8 maj 2022, Prokurori i Specializuar Xhek Smith u riemërua për një mandat katërvjeçar.

Më 18 maj 2022, Trupi Gjykses II shqiptoi aktgjykimin e parë në DHSK në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt* duke i shpallur të dy të akuzuarit fajtorë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësim gjatë procedurës penale dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës.

Më 17 qershor 2022, z. Gucati dhe z. Haradinaj dorëzuan njoftimet për apel kundër aktgjykimit.

Më 21 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës* Trupit Gjykses I.

Më 19 nëntor 2022, pas largimit të z. Xhek Smith, z. Aleks Uajting u emërua Ushtrues i Detyrës së Prokurorit të Specializuar.

Më 1 dhe 2 dhjetor 2022, Paneli i Gjykatës së Apelit mbajti seancë të apelit në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt*.

Më 15 dhjetor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi Trupit Gjykses II çështjen *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçi dhe të tjerëve*.

Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykses I shqiptoi aktgjykimin në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës*, duke e shpallur të akuzuarin fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës, dhe vrasjes së paligjshme.

2023

Më 2 shkurt 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit shqiptoi aktgjykimin në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt*, duke konfirmuar aktgjykimin, por duke i ulur dënimet në katër vjet e tre muaj burg.

Më 21 dhe 22 shkurt 2023, filloi gjykimi i çështjes *Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës* me deklaratat hyrëse të palëve dhe të Mbrojtësit të Viktimave.

Më 3 prill 2023, filloi gjykimi i çështjes gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçi dhe të tjerëve*, me deklaratat hyrëse të Prokurorit të Specializuar.

Më 2 qershor 2023, pas z. Xhek Smith si prokurore e specializuar u emërua znj. Kimbërl P. Uest.

Më 31 korrik 2023, autoritetet lokale në Shqipëri, në zbatim të një fletarrestimi të DHSK-së, arrestuan z. Dritan Goxhaj, i cili më pas u lirua me një vendim të Gjykatës së Apelit të Shqipërisë.

Më 5 tetor 2023, Në Kosovë u arrestuan z. Ismet Bahtijari dhe z. Sabit Januzi mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Më 12 tetor 2023 u ndryshua dënimi i z. Hysni Gucati për të mundësuar lirin e tij me kushte të caktuara në Kosovë.

Më 2 nëntor 2023 u arrestua në Kosovë Isni Kilaj mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Më 11 dhjetor 2023 u arrestua në Kosovë z. Haxhi Shala mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Më 12 dhjetor 2023 u ndryshua dënimi i z. Nasim Haradinaj për të mundësuar lirin e tij me kushte të caktuara në Kosovë.

Më 14 dhjetor 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit shqiptoi aktgjykimin e apelit në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës*, duke konfirmuar pjesërisht aktgjykimin dhe e uli dënimin në 22 vjet burg.

2024

Më 15 maj 2024, me një urdhër të Gjykatës të Vetëm dhe me kushte të rrepta u lirua në Kosovë z. Isni Kilaj, i cili është i dyshuar.

Më 6 qershor 2024, pas dorëheqjes së Gjykatës Nikola Giju, në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë u emërua Gjykatësja Marzhori Masëlo, e cila po atë ditë u caktua Gjykatëse e Vetme dhe Gjykatëse e Procedurës Paraprake.

Më 16 korrik 2024, Trupi Gjykues I shqiptoi aktgjykimin në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës*.

Më 4 shtator 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ia kaloi Trupit Gjykues I çështjen *Prokurori i Specializuar k. Sabit Januzit dhe të tjerëve*.

Më 10 shtator 2024, Paneli i Gjykatës së Apelit ia uli z. Salih Mustafa dënimin nga 22 vjet në 15 vjet burg.

Më 5 dhjetor 2024, z. Isni Kilaj, z. Bashkim Smakaj dhe z. Fadil Fazliu u arrestuan në Kosovë me akuza lidhur me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Më 6 dhjetor 2024, palët në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Sabit Januzit dhe të tjerëve* dorëzuan kërkesën për marrëveshjen e pranimi të fajësisë.

Më 8 dhe 9 dhjetor 2024, z. Hashim Thaçi, z. Bashkim Smakaj, z. Isni Kilaj, z. Fadil Fazliu dhe z. Hajredin Kuçi bënë paraqitjet e para në lidhje me akuzat për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Më 24 dhjetor 2024, me përfundimin e kryerjes së dënimit u mbyll përfundimisht çështja në lidhje me z. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj.



2011



Janar 2011

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (KE) miraton Raportin mbi "Trajtimin çnjerëzor të personave dhe trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë".

Shtator 2011

Fillon punën Task Forca Hetimore Speciale (TFHS), e ngritur nga BE-ja për kryerjen e hetimeve penale në lidhje me pretendimet në Raportin e KiE-së.

2014

Prill 2014

Presidentja e Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për politikë të jashtme dhe të sigurisë shkëmbejnë letra në lidhje me krijimin e "dhomave të veçanta gjyqësore".

2015

Gusht 2015

Kuvendi i Kosovës miraton nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjin për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

2016



Prill 2016

Dr. Fidelma Donlon emërohet Administratore e DSK-së, që shënon fillimin e punës së institucionit gjyqësor në Hagë.



Shtator 2016

Z. Dejvid Shvendiman emërohet Prokuror i Specializuar.



Dhjetor 2016

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova emërohet Kryetare e DSK-së.

2017

Janar 2017

Hyn në fuqi Marrëveshja me Shtetin Pritës midis Kosovës dhe Holandës, që i mundëson DHSK-së kryerjen e procedurave penale në Holandë.



Shkurt 2017

Emërohen 19 gjykatës në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë.

Mars 2017

Gjykatësit miratojnë Rregulloren e Procedurës dhe të Provave, e cila më pas shqyrtohet nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese.

Korrik 2017

Hyn në fuqi Rregullorja e Procedurës dhe e Provave pas vlerësimit të kushtetutshmërisë së saj nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese dhe DHSK-ja bëhet funksionale në aspektin gjyqësor.

Nëntor 2017

Administratorja miraton Direktivën për Mbrojtësit, e cila përcakton kriteret për përzgjedhjen e mbrojtësve për përfaqësimin e të dyshuarve, të akuzuarve dhe viktimave para DHSK-së C.

2018



Maj 2018

Z. Pietro Spera emërohet Avokat i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës.



Shtator 2018

Z. Xhek Smith emërohet Prokuror i Specializuar pas z. Dejvid Shvendiman.

2019



Qershor 2019

DHSK-ja dhe ZPS-ja zhvendosen në mjediset e reja.

2020

Shkurt dhe prill 2020

Prokurori i Specializuar paraqet aktakuzat e para.

Prill 2020

Administratorja Fidelma Donlon riemërohet për një mandat tjetër katërvjeçar.

Shtator 2020

Gjashtë gjykatës të rinj bëjnë betimin dhe Prokurori i Specializuar arreston z. Salih Mustafa mbi bazën e akuzave për krime lufte, si dhe z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj mbi bazën e akuzave për vepra penale.

Nëntor 2020

Prokurori i Specializuar arreston z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi për krime të pretenduara kundër njerëzimit dhe për krime lufte.

Dhjetor 2020

Kryetarja Ekaterina Trendafilova riemërohet për një mandat katërvjeçar.

2021



Mars 2021

Z. Pjetër Shala arrestohet në Belgjikë mbi bazën e akuzave për krime lufte.



Shtator 2021

Fillon procesi i gjykimit në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës.

Tetor 2021

Fillon procesi i gjykimit në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt.

2022



Mars 2022

Përfundon gjykimi në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt.

Maj 2022

Prokurori i Specializuar Xhek Smith riemërohet për një mandat katërvjeçar.

Maj 2022

Trupi Gjykues II shqipton aktgjykimin e parë të DHSK-së në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt.

Qershor 2022

Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj dorëzojnë njoftimet për apel kundër aktgjykimit.

Shtator 2022

Përfundon gjykimi në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës*.



Nëntor 2022

Pas largimit të z. Xhek Smith, z. Aleks Uajting emërohet Ushtrues i Detyrës së Prokurorit të Specializuar.



Dhjetor 2022

Seanca e apelit në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*.



Dhjetor 2022

Trupi Gjykues I shqipton aktgjykimin e parë të DHSK-së për krime lufte në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës*.

2023

Shkurt 2023

Paneli i Gjykatës së Apelit shqipton aktgjykimin në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*.



Shkurt 2023

Fillon gjykimi i çështjes gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës*.



Pril 2023

Fillon gjykimi i çështjes gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve*.



Qershor 2023

Znj. Kimbërli Uest emërohet si Prokurorja e re e Specializuar.

Korrik 2023

Z. Dritan Goxhaj arrestohet në Shqipëri nga autoritetet lokale i akuzuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe më pas lirohet nga Gjykata Shqiptare e Apelit.



Tetor 2023

Prokurorja e Specializuar arreston z. Ismet Bahtijari dhe z. Sabit Januzi të akuzuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Tetor 2023

Ndryshohet dënimi i z. Hysni Gucati për të mundësuar lirimin e tij me kushte të caktuara në Kosovë.



Nëntor 2023

Prokurorja e Specializuar arreston në Kosovë z. Isni Kilaj i akuzuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.



Dhjetor 2023

Prokurorja e Specializuar arreston z. Haxhi Shala i akuzuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Dhjetor 2023

Ndryshohet dënimi i z. Nasim Haradinaj për të mundësuar lirimin e tij me kushte të caktuara në Kosovë.



Dhjetor 2023

Paneli i Gjykatës së Apelit shqipton aktgjykimin në çështjen Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës.

2024

Maj 2024

Lirohet në Kosovë me kushte të rrepta z. Isni Kilaj.



Qershor 2024

Gjykatësja Marzhori Masëlo emërohet në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë dhe caktohet Gjykatëse e Vetme dhe Gjykatëse e Procedurës Paraprake.



Korrik 2024

Trupi Gjykues I shqipton aktgjykimin në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës*.

Shtator 2024

Gjykatësja e Procedurës Paraprake ia kalon Trupit Gjykues I çështjen *Sabit Januzi dhe të tjerët*.

Shtator 2024

Paneli i Gjykatës së Apelit e ul dënimin e z. Salih Mustafa nga 22 në 15 vjet burg.



Dhjetor 2024

Arrestohen në Kosovë z. Bashkim Smakaj, z. Isni Kilaj dhe z. Fadil Fazliu nën akuza që kanë lidhje me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Dhjetor 2024

Palët në çështjen *Sabit Januzi dhe të tjerët* dorëzojnë kërkesa për marrëveshje të pranimit të fajësisë.

Dhjetor 2024

Seancat e para paraqitëse të z. Hashim Thaçi, z. Bashkim Smakaj, z. Isni Kilaj, z. Fadil Fazliu dhe z. Hajredin Kuçi në lidhje me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Dhjetor 2024


Z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj përfundojnë kryerjen e dënimit.



Dhjetor 2024

Gjykatës Pjetër Hofmansi emërohet në Gjykatën Kushtetuese.

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) janë dy institucione të pavarura, të ngritura pas Shkëmbimit të Letrave në përputhje me legjislacionin e Kosovës, me anë të ndryshimit kushtetues në vitin 2015. Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) u miratua nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015.



■ Mandati i DHSK-së është

- “garantimi i procedurave penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase në lidhje me pretendimet për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë konfliktit në Kosovë dhe pas tij, krime të cilat ndërlidhen me ato që janë raportuar në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës [...] dhe të cilat kanë qenë objekt i hetimeve penale të Task Forcës Hetimore Speciale” (neni 1 i Ligjit).

■ DHSK-ja u krijua në përputhje me Shkëmbimin e Letrave dhe legjislacionin e Kosovës dhe

- ka të njëjtat shkallë gjykimi si sistemi gjyqësor i Kosovës (shkallën e parë, të apelit, supreme, kushtetuese)
- ka seli jashtë Kosovës
- përbëhet nga gjykatës dhe punonjës që janë shtetas të shteteve anëtare të BE-së ose të shteteve të treta kontribuuese
- zbaton të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe të drejtën penale materiale të Kosovës sikurse përcaktohet në Ligj
- zbaton rregulloren e vet të procedurës dhe provave.

■ DHSK-ja është institucion gjyqësor i përkohshëm

- që do të ekzistojë vetëm për sa kohë që do të jetë e nevojshme për gjykimin e akuzave të paraqitura nga Prokurori i Specializuar dhe deri sa Këshilli i BE-së të njoftojë Kosovën për përfundimin e hetimeve dhe proceseve gjyqësore.


■ Juridiksioni i DHSK-së përfshin

- krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera sipas të drejtës penale në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve
 - që kanë ndodhur midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000
 - që kanë filluar të kryhen apo janë kryer në Kosovë, ose që janë kryer nga persona me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë, ose kundër personave me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë
- vepra penale të caktuara kundër administrimit të drejtësisë kur kanë lidhje me procedurat zyrtare dhe/ose me zyrtarë të DHSK-së.

■ DHSK-ja merret vetëm me përgjegjësi penale individuale - nuk mund të gjykojnë grupe ose organizata.

■ DHSK-ja lejon pjesëmarrjen e viktimave në procese gjyqësore.

- DHSK-ja dhe ZPS-ja financohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtete të treta kontribuuese dhe janë të pavarura në përmbushjen e mandatit dhe kryerjen e punës së tyre.
- Gjuhët zyrtare të DHSK-së dhe ZPS-së janë shqipja, serbishtja dhe anglishtja.
- DHSK-ja ka Avokatin e Popullit, i cili vepron në mënyrë të pavarur për monitorimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në, ndër të tjera
 - përmes procedurës së parashtimit të ankesave prej personave
 - në qoftë se ankesa e tyre ka të bëjë me ndërveprimin e tyre me DHSK-në ose ZPS-në
 - në rast të vonësave të paarsyeshme të një procesi në DHSK
 - në qoftë se janë shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike
 - në qoftë se ankesa paraqitet brenda gjashtë muajsh nga shkelja e pretenduar
- duke hyrë dhe inspektuar në çdo kohë dhe pa paralajmërim objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, për vlerësimin e kushteve të paraburgimit.







DHOMAT

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) kanë vazhduar proceset e tyre gjyqësore me një ecuri tepër frytdhënëse dhe efikase duke shënuar një numër të rëndësishëm arritjesh gjatë vitit. Konkretisht, procesi i krimeve të luftës në çështjen e Prokurorit të Specializuar k. Salih Mustafës përfundoi me uljen e dënimit nga ana e Panelit të Apelit në 10 shtator 2024, pas vendimit të dhënë nga Paneli i Gjykatës Supreme. Aktgjykimi i dytë i DHSK-së në një çështje për krimet e luftës u shqiptua më 16 korrik 2024 në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës*, ndërkohë që më pas kanë filluar procedurat të apelit.

Në nëntor 2024, në çështjen e Prokurorit të Specializuar k. Sabit Januzit dhe të tjerëve, për herë të parë në DHSK u dorëzuan kërkesa për marrëveshje për pranimin e fajësisë, të cilat u shqyrtuan nga Trupi Gjyqësor I nga fundi i vitit 2024. Procesi gjyqësor në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të*

tjerëve vazhdoi me ritëm të efektshëm, ndërkohë që dy dënimet e dhëna nga DHSK-ja u kryen plotësisht nga të dënuarit në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucatit dhe Hasim Haradinajt*, çështje kjo e lidhur me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë. Çështja kundër Hashim Thaçit dhe katër personave të tjerë me akuza për administrimin e drejtësisë ishte ende në vazhdim në fund të periudhës së raportimit dhe i hapi rrugën tre arrestimeve.

Gjatë vitit 2024 të gjithë nivelet e Dhomave të Specializuar kanë qenë të ngarkuara me punë, duke përfshirë edhe Gjykatësen e Vetme, Gjykatësen e Procedurës Paraprake, dy Trupat Gjyqësorë, Panelet e Gjykatës së Apelit, Panelin e Gjykatës Supreme dhe Gjykatën Kushtetuese (DHSGJK), si edhe Kryetaren. Gjatë gjithë vitit, panelet dhe Kryetarja kanë lëshuar së bashku 978 vendime dhe urdhra, nga të cilat 137 të lëshuara gojarisht.

a.

PROCESET PARA GJYKATËSIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE

Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve (vepra penale kundër administrimit të drejtësisë)

Më 2 nëntor 2023, në Kosovë u arrestua z. Isni Kilaj në zbatim të një urdhri të lëshuar nga Prokurori i Specializuar. Urdhri i arrestimit u lëshua për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, ku përfshiheshin pengimi i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe shkelje të fshehtësisë së procedurave. Z. Kilaj u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së më 3 nëntor 2023.

ZPS-ja parashtroi Aktakuzën paraprake në lidhje me z. Kilaj më 15 dhjetor 2023, e cila u pasua me aktakuzën e rishikuar më 11 mars 2024. Më 2 maj 2024, ZPS-ja kërkoi pezullimin e shqyrtimit të aktakuzës së rishikuar për konfirmim.

Gjykatësi i Vetëm e pranoi kërkesën e ZPS-së, por më 15 maj 2024 urdhëroi lirimin me kushte të rrepta të z. Kilaj në Kosovë. Gjykatësi i Vetëm arsyetoi se në këto rrethana zgjatja e paraburgimit të z. Kilaj në Hagë do të ishte e paarsyeshme, duke marrë parasysh, ndër të tjera, prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për liri. Pas kësaj, më 18 qershor 2024 ZPS-ja dorëzoi një aktakuzë edhe të ndryshuar më tej, e cila u konfirmua më 29 nëntor 2024. Z. Kilaj u arrestua më 5 dhjetor 2024. Në seancën e paraqitjes së parë më 9 dhjetor 2024 ai u vetëdeklarua i pafajshëm.

Më 5 dhjetor 2024 u arrestuan në Kosovë dhe të nesërmen u sollën në objektin e paraburgimit në Hagë dy persona të tjerë, përkatësisht z. Bashkim Smakaj dhe z. Fadil Fazliu.

Kjo është çështja më e re e DHSK-së në lidhje me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë. Aktakuza në këtë çështje pretendon se z. Hashim Thaçi, z. Bashkim Smakaj, z. Isni Kilaj, z. Fadil Fazliu dhe z. Hajredin Kuçi janë përpjekur në mënyrë të paligjshme të ndikojnë mbi dëshmitarët që po dëshmojnë në çështjen e lidhur me krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit kundër z. Hashim Thaçit dhe të bashkakuzuarve të tij.



Z. Isni Kilaj gjatë paraqitjes së parë, 9 dhjetor 2024



Z. Hashim Thaçi gjatë paraqitjes së parë,
8 dhjetor 2024



Z. Hajredin Kuçi gjatë paraqitjes së parë,
9 dhjetor 2024



Z. Bashkim Smakaj gjatë paraqitjes së parë,
8 dhjetor 2024



Z. Fadil Fazliu gjatë paraqitjes së parë,
8 dhjetor 2024

Z. Thaçi, z. Smakaj dhe z. Fazliu bënë paraqitjet e tyre të para te Gjykatësja e Procedurës Paraprake më 8 dhjetor 2024, gjatë të cilave ata ose zgjodhën të mos vetëdeklaroheshin për fajësinë ose të vetëdeklaroheshin të pafajshëm.

Z. Kuçi u thirr për t'u paraqitur në Dhomat e Specializuara më 9 dhjetor 2024, ku ai u vetëdeklarua i pafajshëm në lidhje me akuzat kundër tij.

Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçi dhe të tjerëve.

Procesi gjyqësor në çështjen kundër z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi filloi më 3 prill 2023 me deklaratat hyrëse të Prokurorit të Specializuar. Deri në fund të vitit 2024, ZPS-ja kishte thirrur për të dëshmuar 110 dëshmitarë, ndërkohë që ishin pranuar si prova mbi 80 deklaratat dëshmitarësh.

Gjatë këtij viti, Trupi Gjyqësor II mbajti disa seanca posaçërisht për të diskutuar me palët mënyrat për ta racionalizuar procesin gjyqësor dhe që të zhvillohet në mënyrë më të efektshme. Kjo solli si rezultat, ndër të tjera, që më 1 tetor 2024 ZPS-ja të deklaronte se synonte të thërriste për të dëshmuar 12 dëshmitarë më pak se sa kishte planifikuar fillimisht dhe se disa dëshmi të dëshmitarëve do të paraqiteshin në formë të shkruar, jo me paraqitjen e tyre në sallë. Gjatë këtyre konferencave mbi ecurinë e çështjes, Trupi Gjyqësor II i nxiti edhe më tej palët që të vazhdonin të shihnin

mundësinë e garantimit të mëtejshëm të hapjes së procesit për publikun pa rrezikuar sigurinë e dëshmitarëve.

Z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi akuzohen secili me nga 10 akuza – katër akuza për krime lufte dhe gjashtë akuza për krime kundër njerëzimit. Në aktakuzë thuhet se krimet për të cilat ngrihen akuzat janë kryer të paktën nga marsi 1998 deri në shtator 1999 në disa vende të Kosovës si edhe në Kukës dhe Cahan, në Shqipërinë Veriore. Pretendohet se këto krime u kryen nga anëtarë të UÇK-së kundër qindra civilëve dhe personave që nuk merrnin pjesë në luftime.

Në këtë çështje janë 154 viktima pjesëmarrëse.



Seancë në çështjen Thaçi dhe të tjerë, 15 korrik 2024

Trupi Gjyqësor II, i emëruar nga Kryetarja për këtë çështje, përbëhet nga gjykatësit Çarls Smith III, (kryegjykatës) Kristof Barte, Ginel Metro dhe Fergal Gejnor (gjykatës rezervë).



Trupi Gjykses II gjatë seancave në çështjen Taçi dhe të tjerë, 15 korrik 2024

Trupi Gjykses e pranon që Viktima-296/06 është njeri i zakonshëm që nuk ishte i vetëdijshëm se kishte afate për të bërë kërkesë që të merrte pjesë si viktimë në procesin gjyqësor, që ZPV-ja kishte bërë disa herë përpjekje me vullnet të mirë që të lidhej me kërkuesin dhe që këto përpjekje nuk kishin qenë të suksesshme. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh rrethanat e përmendura më lart dhe duke vërejtur se asnjë nga palët nuk e kundërshton kërkesën, Trupi Gjykses është bindur se janë paraqitur arsye të vlefshme për ta vlerësuar si të pranueshme përcjelljen e kërkesës së Viktimës 296/06 pas afatit të përcaktuar në Urdhër.

KSC-BC-2020-06/F02439/RED, Version i Redaktuar Publik i Raportit të Gjashtëmbëdhjetë të Zyrës Administrative mbi Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces, 10 korrik 2024, para. 10

Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës

Procesi gjyqësor në çështjen kundër z. Pjetër Shalës filloi më 21 dhe 22 shkurt 2023 me deklaratat hyrëse të Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të Specializuar, Mbrojtjes dhe Mbrojtësit të Viktimave. Sipas aktakuzës, z. Shala, që ishte anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) me bazë në Kukës, Shqipëri, është përgjegjës për katër krime lufte, (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme). Këto krime lufte pretendohet se u kryen afërsisht në periudhën nga 17 maji 1999 deri më 5 qershor 1999 ndaj personave të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës që shfrytëzohej nga UÇK-ja.

Procesi i paraqitjes së provave për këtë çështje u mbyll më 9 shkurt 2024, ndërsa argumentet përmbyllëse u zhvilluan nga 15 deri më 17 prill 2024.

Më 16 korrik 2024 Trupi Gjykses I shqiptoi aktgjykimin, versioni publik me shkrim i të cilit u botua më 24 shtator. Trupi Gjykses e shpalli z. Shala fajtor për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje si krime lufte dhe e dënoi me 18 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.

Gjatë gjithë kohës së mbajtjes në ndalim, të ndaluarit u morën në pyetje dhe u akuzuan si “bashkëpunëtorë” të autoriteteve serbe, “spiunë”, “tradhtarë”, simpatizues të Serbisë, ose se nuk e përkrahnin mjaftueshëm luftën e UÇK-së. Kushtet çnjerëzore të ndalimit dhe keqtrajtimet fizike dhe psikologjike të të ndaluarve kishin për qëllim marrjen e informatave ose të deklaratave pranuese prej tyre dhe/ose ndëshkimin, frikësimin, detyrimin dhe/ose diskriminimin e tyre për arsye politike.

KSC-BC-2020-04/F00847/RED, Version i redaktuar publik i Aktgjykimit dhe Dënimit, 16 korrik 2024, para. 1089.



Trupi Gjykes I gjatë shqiptimit të aktgjykimit në çështjen e Pjetër Shalës, 16 korrik 2024

Në proces dëshmuan gjithsej 22 dëshmitarë, (10 për ZPS-në, dy për Mbrojtësin e Viktimave dhe 10 për Mbrojtjen). Si prova u pranuan edhe 11 deklarata të tjera nga dëshmitarët (shtatë prej tyre të dhëna për ZPS-në dhe katër për Mbrojtjen). Në këtë çështje ishin tetë viktima pjesëmarrëse, të gjithë shqiptarë të Kosovës.

Më 29 nëntor 2024, Trupi Gjykes lëshoi urdhrin për zhdëmtim në këtë çështje. Trupi Gjykes urdhëroi z. Shala të paguajë 208.000 euro si kompensim për dëmin fizik, mendor dhe material që iu është shkaktuar viktimave të krimeve për të cilat ai u dënua.

Trupi Gjykes I i emëruar për këtë çështje, përbëhej nga gjykatësit Mapi Feld-Folia, (Kryegjykatëse), Roland Dekers, Zhilber Biti dhe Vladimir Mikula (rezervë).



Z. Pjetër Shala gjatë dhënies së aktgjykimit,
16 korrik 2024

Prokurori i Specializuar k. Sabit Januzit dhe të tjerëve

Z. Sabit Januzi dhe z. Ismet Bahtijari u arrestuan në Kosovë më 5 tetor 2023 nga ZPS-ja në bazë të fletarrestimeve, urdhrave për transferim dhe aktakuzës së konfirmuar lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në atë kohë, gjykatës Nikola Giju, më 2 tetor 2023. Të dy të akuzuarit u transferuan në objektin e paraburgimit më 6 tetor 2023.

Më 4 dhjetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi akuzat kundër z. Haxhi Shala për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe lëshoi fletarrestimin e tij. Sipas aktakuzës, z. Shala, së bashku me persona të tjerë, përfshirë edhe z. Januzi dhe z. Bahtijari, bashkërenduan veprimet që të paktën midis datave 5 dhe 12 prill 2023 t'i qasen një dëshmitari që kishte të ngjarë të jepte informacion për ZPS-në ose DHSK-në për krime që janë në juridiksionin e gjykatës.

Z. Shala u arrestua në Kosovë më 11 dhjetor 2023 dhe u transferua në objektin e paraburgimit më 12 dhjetor 2023.

Më 8 shkurt 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi kërkesën e ZPS-së për bashkimin e çështjeve të z. Januzi dhe z. Bahtijari me atë të z. Shala dhe më 4 shtator 2024 çështja iu përcoll Trupit Gjykues I.

Konferencat përgatitore për gjykim u mbajtën më 7 dhe 8 tetor 2024 ndërsa fillimi i paraqitjes së argumenteve nga ana e ZPS-së, i parashikuar të zhvillohej më 14 nëntor 2024, u shty pas një kërkesë të palëve.

Më 6 dhjetor 2024, ZPS-ja dhe tre të akuzuarit i paraqitën marrëveshjet për pranimin e fajësisë Trupit Gjykues I, që më 18 dhjetor 2024 thirri seancën për diskutimin e marrëveshjeve. Deri në fund të vitit 2024 Trupi Gjykues I ishte ende duke shqyrtuar marrëveshjet për pranimin e fajësisë në përputhje me Rregulloren e DHSK-së.

Trupi Gjykues I, i caktuar për këtë çështje, përbëhej nga Gjykatësit Mapi Feld-Folia, (Kryegjykatëse), Roland Dekers, Zhilber Biti dhe Vladimir Mikula (gjykatës rezervë).



Z. Sabit Januzi gjatë paraqitjes së mëtejshme, 12 korrik 2024



Z. Ismet Bahtijari gjatë paraqitjes së mëtejshme, 12 korrik 2024



Z. Haxhi Shala gjatë seancës për pranimin e fajësisë,
18 dhjetor 2024

Trupi Gjykses rikujton parimin e procesit publik sipas nenit 40(4) të Ligjit. Gjithashtu, Trupi Gjykses rikujton arsyet se përse ka theksuar që mbrohet konfidencialiteti i procesit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë duke pasur parasysh paraqitjen e pritshme të Marrëveshjeve të Rishikuara për Pranimin e Fajësisë. Duke qenë se tashmë ato janë paraqitur nga ZPS-ja, siç janë paraqitur nga palët edhe parashtrimet përkatëse për dënimin, Trupi Gjykses Konstaton se mbrojtja e mëtejshme e konfidencialitetit të procesit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk është më e arsyeshme (...) Për të njëjtën arsye, Trupi Gjykses vendos që seancat e procesit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë sipas planit të mëposhtëm, të jenë të hapura për publikun.

KSC-BC-2023-10/F00626/RED, Versioni i redaktuar Publik i Vendimit për Caktimin e Rendit të Ditës për Seancën mbi Procesin e Pranimin të Fajësisë, Kërkesës për Parashtrime dhe Çështje të Lidhura me To, 13 dhjetor 2024, para. 17.

C.

PROCESET PARA GJYKATËS SË APELIT

Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës

Më 14 dhjetor 2023 Gjykata e Apelit lëshoi aktgjykimin e saj të apelit në çështjen e Salih Mustafës. Paneli i Gjykatës së Apelit konfirmoi dënimet e Mustafës për krimet e luftës së ndalimit arbitrar (akuza 1), torturë (akuza 3) dhe vrasje (akuza 4). Paneli pranoi pjesërisht kundërshtimin e Mustafës ndaj masës së dënimit të Trupit Gjykses prej 26 vjetësh burgim, pasi analizoi çështje në tribunalët ndërkombëtarë dhe në gjykatat e Kosovës. Paneli i Gjykatës së Apelit ia uli z. Mustafa dënimin e gjithsejtë të njësuar nga 26 vjet burgim në 22 vjet, ku llogaritet edhe koha e paraburgimit. Gjithashtu Paneli theksoi se Urdhri për Zhdëmtim i lëshuar më 6 prill 2023 nuk ndikohej nga aktgjykimi i apelit.

Pas referimit në Gjykatën Supreme dhe vendimit të saj të mëposhtëm më 29 korrik 2024, në përputhje me rregullën 194(1)(b) të Rregullores, çështja iu rikthye Panelit të Gjykatës së Apelit për të shqyrtuar uljen e

dënimit. Më 10 shtator 2024, i njëjti Panel i Gjykatës së Apelit vendosi një dënim të ri të gjithsejtë të njësuar prej 15 vjetësh, ku llogaritet edhe koha e paraburgimit.

Paneli i Gjykatës së Apelit përbëhej nga Gjykatësit Mishelë Pikar (Kryegjykatëse), Kai Ambos dhe Nina Jorgensen.



Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës

Pas lëshimit të aktvendimit më 16 korrik 2024, më 2 shtator 2024 z. Shala dorëzoi njoftimin për apelim dhe më 20 shtator 2024 u zhvillua një konferencë para apelit. Në fund të vitit 2024 procesi i apelit për këtë çështje ishte ende në vazhdim.

Paneli i Gjykatës së Apelit që u caktua për këtë çështje përbëhej nga gjykatësit Mishelë Pikar (Kryegjykatëse), Kai Ambos dhe Nina Jorgensen.



Konferenca para apelit në çështjen P. Shala, 20 shtator 2024

Apelet e ndërmjetme

Me përparimin e ndjeshëm të bërë në çështjet para DHSK-së, gjatë vitit 2024 panelet e Gjykatës së Apelit ishin gjithashtu të ngarkuara me një gamë të gjerë apelesh. Ato dhanë vendime në një numër çështjesh

të apelueshme, duke përfshirë vazhdimin e paraburgimit, pjesëmarrjen e viktimave dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve.

Gjithashtu Paneli rikujton se nevoja për të vepruar me zell dhe shpejtësi bëhet edhe më e ngutshme në rastin kur personi është ndaluar përpara se të dorëzohet aktakuza, sepse korniza ligjore e Dhomave të Specializuara e kufizon një mundësi të tillë në një periudhë që nuk mund të shkojë më shumë se një vit dhe konkretisht kërkon nga ZPS-ja të arsyetojë të gjitha kërkesat për shtyrje të afatit sepse e marrja e masave të mëtejshme hetimore është e domosdoshme.

KSC-BC-2018-01/IA007/F00007RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Zyrës së Prokurorisë kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt, 15 maj 2024, para. 19.

Paneli i Apelit së rikujton së pari se: (i) privilegji i mosinkriminimit të vetes nuk mbron nga dhënia e deklaratave inkriminuese në vetvete, por nga dhënia e provave me anë të shtrëngimit ose presionit dhe (ii) neni 6 i KEDNJ-së shkelet pikërisht atëherë kur shkalla e detyrimit shkatërron vetë thelbin e privilegjit të mosinkriminimit të vetes.

KSC-BC-2020-06/IA030/F00009, Vendim mbi Apelet e Krasniqit dhe Selimit ndaj Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 31 maj 2024, para. 42.

d.

PANELI I GJYKATËS SUPREME

Gjatë vitit 2024 Paneli i Gjykatës Supreme ishte i ngarkuar me një numër çështjesh të ndryshme.

Më 25 janar 2024, Paneli i Gjykatës Supreme lëshoi dy vendime në lidhje me një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në çështjen e Salih Mustafës.

Në vendimin e parë Paneli konstatoi se mbrojtësja Venkatesvari Alagendra nuk kishte njoftuar Trupin Gjykses II (para të cilit akuzohet edhe Jakup Krasniqi që ajo gjithashtu e përfaqëson) se ajo synonte të përfaqësonte z. Mustafa, siç kërkohet sipas nenit 28(4) (1) (b) të Kodit të Etikës Profesionale, për të marrë vendimin e Trupit Gjykses nëse kishte konflikt interesi. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses deklaroi se caktimi i znj. Alagendra si mbrojtëse e re e z. Mustafa nuk kishte efekt ligjor dhe urdhëroi Administratoren të caktonte një mbrojtës kujdestar për të përfaqësuar z. Mustafa deri sa të zgjidhej çështja.

Në një vendim të dytë, Trupi Gjykses hodhi poshtë kërkesën e z. Mustafa për zgjatjen e afatit të

dorëzimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë sepse në atë kohë znj. Alagendra nuk ishte e autorizuar për të dorëzuar kërkesa në emër të tij, përfshirë edhe kërkesën për zgjatjen e afatit. Gjithashtu, Trupi Gjykses theksoi se, edhe po të ishte e autorizuar, afatet që përcakton Ligji (kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë duhet të dorëzohen brenda tre muajve nga aktgjykimi përfundimtar) nuk mund të ndryshohen me Rregullore.

Më 29 korrik 2024, Gjykata Supreme miratoi pjesërisht kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dorëzuar nga z. Mustafa, pas lëshimit të vendimit të apelit në çështjen e tij gjyqësore, për aq sa ajo kishte lidhje me përcaktimin e dënimit të tij. Paneli i Gjykatës Supreme ia ktheu çështjen Panelit të Apelit, sipas rregullës 194(1)(b) të Rregullores, për të shqyrtuar uljen e dënimit të z. Mustafa sipas arsyetimit të dhënë në vendimin e Panelit të Gjykatës Supreme. Më 10 shtator 2024, Paneli i Gjykatës së Apelit ia uli dënimin z. Mustafa nga 22 vjet burg në 15 vjet, ku llogaritet edhe koha e paraburgimit.

Paneli thekson se ndonëse neni 44(2) i Ligjit nuk u referohet ligjeve konkrete vendore, ai përcakton shprehimisht që Dhomat e Specializuara të evidentojnë shkallëzimet e zbatueshme të dënimit të përcaktuara në legjislacionin e Kosovës në përputhje me nënparagrafët (a) dhe (b). Në këtë aspekt, Dhomat e Specializuara janë të detyruara të marrin në konsideratë se cili prej shkallëzimeve përkatëse të dënimit sipas legjislacionit të Kosovës është më i butë, në përputhje me parimin lex mitior. Më pas, paneli që shqipton dënimin duhet ta marrë parasysh shkallëzimin në fjalë kur përcakton dënimin me burgim.

KSC-SC-2024-02/F00018, Vendim mbi Kërkesën e Salih Mustafës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 29 korrik 2024, para. 87.

Më 9 shtator 2024, Paneli i Gjykatës Supreme hodhi poshtë një kërkesë të z. Haxhi Shala për mbrojtje të ligjshmërisë duke konstatuar sa nuk kishte ndonjë shkelje të ndjeshme të procedurës as nga ana e Gjykatës të Procedurës Paraprake, i cili kishte urdhëruar vazhdimin e paraburgimit të z. Shala, as nga ana e Panelit të Apelit, i cili e la në fuqi vendimin. Z. Shala ankohej se Gjykatësi i Procedurës Paraprake


nuk kishte dhënë vendim të arsyetuar mbi vazhdimin e paraburgimit të tij gjatë paraqitjes së parë përpara Gjykatës të Procedurës Paraprake.

Më pas Paneli i Gjykatës Supreme hodhi poshtë kërkesën e z. Shala për rishikim të vendimit të tij, me konstatimin se z. Shala nuk ka vërtetuar gabim në arsyetim ose gabim gjyqësor.

Veçanërisht, Paneli vëren se gjatë seancës së paraqitjes së parë dhe në prani të Mbrojtësit të z. Shala, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kërkoj z. Shala të shtronte çdo problem që mund të kishte në lidhje me arrestimin e tij, transferimin në Hagë ose paraburgimin. Z. Shala u përgjigj se nuk kishte asgjë për të shtuar dhe “çdo gjë ishte në rregull” dhe pas kësaj Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendosi që z. Shala do të vazhdonte të mbahej në paraburgim. Me fjalë të tjera, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i dha z. Shala rastin të paraqiste çdo lloj shqetësimi në lidhje me paraburgimin e tij sipas kuptimit të nenit 5(3) të KEDNJ-së dhe, më tej, pasi dëgjoi përgjigjen e z. Shala, konfirmoi vazhdimin e paraburgimit të tij në përputhje me jurisprudencën përkatëse të GJEDNJ-së.

KSC-BC-2023-10/PL001/F00006, Vendim mbi Kërkesat e Haxhi Shalës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 9 shtator 2024, para. 42.

Paneli i Gjykatës Supreme ishte i ngarkuar me kërkesat referuese nga z. Mustafa dhe ZPS, dorëzuar përkatësisht më 9 dhe 10 dhjetor 2024, në lidhje me vendimin e Panelit të Gjykatës së Apelit për uljen e dënimit të z. Shala në 15 vjet burgim. Në fund të vitit 2024, Paneli i Gjykatës Supreme ishte ende duke i shqyrtuar dy kërkesat referuese.



Gjatë vitit 2024, DHSGJK-ja ishte e ngarkuar me një numër kërkesash referuese.

Më 24 prill 2024, DHSGJK-ja lëshoi vendimin mbi kërkesën referuese të z. Sabit Januzi, z. Ismet Bahtijari dhe z. Haxhi Shala, dorëzuar më 3 prill 2023 në lidhje

me vlefshmërinë kushtetuese të Rregullores për Ndihmë Juridike të DHSK-së. DHSGJK-ja e shpalli të papranueshme kërkesën referuese, sepse Kushtetuta e Kosovës dhe Ligji nuk i japin të drejtë personave privatë t'i drejtojnë Dhomës pyetje që venë në dyshim kushtetutshmërinë e ligjeve.

Që në fillim Dhoma vëren se Rregullorja për Ndihmë Juridike e vitit 2024 përcakton rrugët që ndjek kërkuesi për të kundërshtuar vendimet e marra nga Administratorja në lidhje me shpërndarjen e ndihmës juridike. Në këtë drejtim Dhoma rikujton se, sipas nenit 113(7) të Kushtetutës, si edhe nenit 49(3) të Ligjit dhe rregullës 20(1)(a) të Rregullores së DHSGJK-së, personi mund t'i drejtojë kërkesë referuese Dhomës pasi i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore që ofron ligji kundër shkeljes së pretenduar. Dhoma vëren se në këtë vështrim nuk del as që kërkuesit deri tani të kenë kërkuar ndihmë juridike, as që të jetë marrë ndonjë vendim mbi varfërinë e tyre. Me fjalë të tjera, kërkuesit nuk pretendojnë as që është marrë ndonjë vendim konkret sipas Rregullores për Ndihmë Juridike të vitit 2024, as që ndonjë vendim i tillë të ketë shkelur të drejtat e tyre.

KSC-CC-2024-23/F00006, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Kushtetutshmërinë e Rregullores për Ndihmë Juridike të Dhomave të Specializuara, 24 prill 2024, para. 16.

Më 31 maj 2024, DHSGJK-ja lëshoi vendimin mbi kërkesën referuese të z. Nasim Haradinaj, i cili pretendonte shkelje të të drejtave dhe lirive të tij vetjake në lidhje me procesin penal kundër tij në DHSK. Në gjykimin e saj DHSGJK-ja e deklaroi një

pjesë të ankesës së tij si të papranueshme dhe hodhi poshtë pjesën tjetër, duke konstatuar se nuk kishte pasur asnjë shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ose të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

[...] Dhoma vëren se kërkuesi nuk ka pretenduar kurrë që personat e panjohur që dorëzuan tri pako me materiale konfidenciale, ose ndokush tjetër, meqë ra fjala, kishin bërë, ose në kohën kur u krye dorëzimi ose më vonë, ndonjë përpjekje për ta shtyrë atë që të kryente vepra penale. Përkundrazi, kërkuesi ishte thjesht marrës i dokumenteve konfidenciale që po i dorëzoheshin nga njerëz të panjohur. Rrjedhimisht, vetë kërkuesi duhet të reagojë në mënyrë të ligjshme ndaj ngjarjeve në fjalë. Në vend që ta bënte një gjë të tillë, kërkuesi vendosi, me vullnetin e tij të lirë, të reagojë qëllimisht me një mënyrë të paligjshme.

KSC-CC-2023-22/F00011, Aktvendim mbi Kërkesën Referues të Nasim Haradinaj drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, 31 maj 2024, para. 112.

Më 15 dhjetor 2024, DHSGJK-ja lëshoi vendimin ku hidhte poshtë kërkesën referuese të z. Hashim Thaçi në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të tij themelore të garantuara nga Kushtetuta e Kosovës dhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut lidhur me sistemin e masave të veçanta hetimore të detyrueshme ndaj tij

gjatë kohës kur mbahej si i paraburgosur në objektin e paraburgimit të DHSK-së në pritje të gjykit.

Nga fundi i vitit 2024, DHSGJK-ja ishte ngarkuar me kërkesën referuese të z. Salih Mustafa dhe kërkesën referuese të z. Haxhi Shala. Vendimet për këto kërkesa referuese pritet të lëshohen në fillim të vitit 2025.

Më 8 prill 2024, Kryetarja e DHSK-së Ekaterina Trendafilova hodhi poshtë kërkesën e z. Hashim Thaçi për zëvendësimin e gjykatësit Nikola Giju si Gjykatës i Vetëm në çështjen numër KSC-BC-2018-01 pas emërimit të tij si Gjykatës në Gjykatën Penale Ndërkombëtare. Kryetarja sqaroi se ajo mund ta zëvendësojë gjykatësin kur ky nuk është në gjendje të ushtrojë detyrat e tij për shkak të angazhimit në një veprimtari apo profesion tjetër. Rasti i gjykatësit Giju nuk ishte i tillë.

Gjithashtu, Kryetarja e DHSK-së rrëzoi pa e shqyrtuar kërkesën alternative të Mbrojtjes për heqjen e gjykatësit Giju. Kryetarja ndër të tjera konstatoi se kërkesës i mungonte përmbajtja dhe se Mbrojtja nuk jepte asnjë argument për të vërtetuar se si mund të ndikonte në pavarësinë e gjykatësit Giju pozicioni i tij ligjor në një gjykatë tjetër që nuk ka juridiksion të përbashkët me DHSK-në.

Gjithashtu, në këtë drejtim Kryetarja thekson se z. Thaçi nuk jep asnjë argument për të vërtetuar se si pozita e gjykatësit Giju në një gjykatë që nuk ka asnjë juridiksion të përbashkët me DHSK-në [Gjykatën Penale Ndërkombëtare] mund të ndikojë mbi pavarësinë e tij. Po kështu, z. Thaçi nuk paraqet se çfarë udhëzimesh, nëse do të kishte të tilla, do të merrte gjykatësi Giju nga secili prej kryetarëve, veç atyre që kanë lidhje me anën administrative të çështjes – të cilat nuk kanë asnjë ndikim mbi pavarësinë e gjykatësit Giju. Përkundrazi, z. Thaçi ngatërron argumentet që kanë lidhje me disponueshmërinë e gjykatësit Giju, me të cilat duhet të merret Kryetarja dhe që kanë natyrë administrative, me pavarësinë gjyqësore të Gjykatësit Giju.

KSC-BC-2018-01/F00630, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Zëvendësimin ose Vetëtrëheqjen e Gjykatësit, 8 prill 2024, para. 17.



Kryetare Trendafilova

Më 12 tetor 2023, Kryetarja Trendafilova lëshoi vendimin e parë të DHSK-së për uljen, modifikimin ose ndryshimin e dënimeve. Kryetarja vendosi që dënimi i z. Gucati të ndryshohej për të mundësuar lirimin e tij me kushte në Kosovë më ose përpara 18 tetorit 2023. Më 12 dhjetor 2023, pas raportit të marrë nga Administratorja për sjelljen e z. Haradinaj në objektin e paraburgimit, Presidentja vendosi ta ndryshojë dënimin e z. Haradinaj për të mundësuar lirimin e tij me kushte në Kosovë më ose rreth 14 dhjetorit 2023.

Më 13 qershor 2024, Kryetarja Trendafilova i dha z. Haradinaj paralajmërimin e fundit që t'i bindej të gjitha kushteve të vëna në vendimin e saj për ndryshimin e dënimit lëshuar në dhjetor 2023. Ky paralajmërim vinte pas marrjes së raportit nga Administratorja, që e vinte në dijeni Kryetaren për kontaktet dhe intervistat e z. Haradinaj me median gjatë disa muajve të fundit, pa kërkuar miratimin e duhur sipas përcaktimit në vendimin e Kryetares.

Më 24 dhjetor 2024 z. Gucati dhe z. Haradinaj e përfunduan kryerjen e plotë të dënimit pa asnjë incident tjetër. Kjo ishte çështja e parë e DHSK-së që përfundoi edhe fazën e zbatimit të procesit.

2

Aktivitetet e Kryetares dhe të gjykatësve

Gjykatësit e DHSK-së emërohen në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë (Regjistri) dhe kryejnë funksione gjyqësore sipas nevojës dhe vetëm me kërkesë të Kryetares. Në përputhje me nenin 26 të Ligjit, gjykatësit nuk marrin shpërblim e as përfitime të tjera vetëm për shkak të këtij emërimi. Për më tepër, gjykatësit shpërblehen vetëm kur i cakton Kryetarja të ushtrojnë detyra zyrtare. Gjykatësit e emëruar, për aq sa është e mundur, i kryejnë funksionet e tyre gjyqësore nga distanca.

Në korrik 2023, u publikua një ftesë për propozime për listën rezervë të kandidatëve për të hyrë në Regjistër që të sigurohej funksionimi i efektshëm i veprimtarisë së vazhdueshme dhe të pandërprerë të DHSK-së. Ftesa u mbyll më 15 mars 2024. Çdo emërim në Regjistër hyn në fuqi menjëherë sapo është i pamjaftueshëm numri i gjykatësve në Regjistër. Lista rezervë e Regjistrit ka si qëllim të sigurojë që, në raste dorëheqjesh së gjykatësve në të ardhmen, të mund të kryhet menjëherë zëvendësimi, duke parandaluar kështu vonesat në proceset gjyqësore.

Më 6 qershor 2024, Autoriteti Emërues, Gjeneralmajor Pietro Barbano, e emëroi gjykatësen Marzhori Masëlo (Francë) në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë (Regjistri) në përputhje me nenin 28(4) të Ligjit. Po atë ditë gjykatëse Masëlo bëri betimin solemn.

Emërimi i gjykatëses Marzhori Masëlo erdhi pas dorëheqjes nga Regjistri e gjykatësit Nikola Giju, i cili u zgjodh gjykatës në Gjykatën Penale Ndërkombëtare. Pas emërimit të saj, gjykatëse Masëlo u caktua të zëvendësonte gjykatësin Giju si Gjykatëse e Vetme dhe si Gjykatëse e Procedurës Paraprake në çështjet përkatëse.



Gjykatëse Marzhori Masëlo

Më 3 dhjetor 2024, Autoriteti Emërues, në përputhje me nenin 28(4) të Ligjit emëroi në Regjistër gjykatësin Piotr Hofmanski (Poloni). Po atë ditë gjykatës Hofmanski bëri betimin solemn.

Emërimi i gjykatësit Hofmanski erdhi pas dorëheqjes së gjykatësit Antonio Balsamo si gjykatës i DHSGJK-së. Rrjedhimisht, në bazë të rregullës 26(5) të Ligjit Autoriteti Emërues emëroi gjykatësin Hofmanski për të zëvendësuar gjykatësin Balsamo si një nga tre gjykatësit e DHSGJK-së.



Gjykatës Pjotër Hofmanski

a.

PLENARJA VJETORE

Më 15 mars 2024, gjykatësit u mbledhën në DHSK për plenaren e tyre të nëntë. Gjatë plenares gjykatësit morën nga Kryetarja përditësim për çështjet institucionale në vazhdim, dëgjuan paraqitjet e bëra nga Prokurorja e Specializuar dhe Kryetari i Komitetit Ekzekutues të Trupit të Pavarur Përfaqësues të Këshilltarëve të Specializuar dhe morën edhe një përditësim nga Administratorja.

Më tej gjykatësit ndoqën prezantime nga dy profesionistë të jashtëm për çështje të lidhura me fushën e drejtësisë penale ndërkombëtare.



Plenarja e nëntë e gjykatësve të DSK-së, 15 mars 2024

b.

MBLEDHJA E GJYKATËSVE

Më 6 dhjetor 2024, gjykatësit u mbledhën në Hagë për një seminar në të cilin folës të njohur paraqitën dhe diskutuan me gjykatësit çështje të lidhura me fushën e drejtësisë penale ndërkombëtare.

Gjykatësit në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë



Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare
(Bullgari)



Gjykatës Çarls L. Smith III
Nënkryetar
(SHBA)



Gjykatës Vidar Stensland
Gjykatës Kushtetues
(Norvegji)



Gjykatës Rumen Nenkov
Gjykatës Kushtetues
(Bullgari)



Gjykatës Piotr Hofmański
Gjykatës Kushtetues
(Poloni)



Gjykatëse Romina Inkuť
Gjykatës Kushtetues Rezervë
(Itali)



Gjykatëse Kristinē van den
Vajngart
(Belgjikē)



Gjykatëse Mishelē Pikar
(Francē)



Gjykatës Tomas Laker
(Gjermani)



Gjykatës Emilio Gati
(Itali)



Gjykatës Roland Dekers
(Holandē)



Gjykatës Antonio Balsamo
(Itali)



Gjykatës Kai Ambos
(Gjermani)



Gjykatës Keneth Roberts
(Kanada)



Gjykatëse Mapi Feld-Folia
(Holandē)



Gjykatës Kristof Barte
(Gjermani)



Gjykatës Vladimir Mikula
(Republika Çeke)



Gjykatës Ginel Metro
(Zvicër)



Gjykatës Zhlilber Biti
(Francē)



Gjykatës Daniel Fransen
(Belgjikē)



Gjykatës Fergal Gejnor
(Irlandē)



Gjykatëse Nina Jorgensen
(Norvegji)



Gjykatëse Marzhori Masēlo
(Francē)

Gjatë vitit 2024, Kryetarja Trendafilova vazhdoi të informonte publikun dhe palët e interesuara për aktivitetet e DHSK-së. Për këtë qëllim, Kryetarja u takua në Hagë dhe në Bruksel me përfaqësues të Bashkimit Evropian (BE), të shteteve anëtare të BE-së, të shteteve të treta kontribuuese, të shtetit pritës dhe të Kosovës. Gjithashtu, kur ishte e nevojshme për DHSK-në, Kryetarja ishte në kontakt me Kryetarin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, Gjeneralmajor Xhovani Pietro Barbano.

Kryetarja vizitoi Kosovën nga data 7 deri më 9 tetor 2024. Gjatë vizitës ajo takoi Ministren e Drejtësisë, Sh. e S. Albulena Haxhiu dhe pjesëtarë të ndryshëm të komunitetit ndërkombëtar, duke përfshirë ambasadorët në Kosovë të shteteve anëtare të BE-së dhe të shteteve të treta kontribuuese; shefin e zyrë së BE-së në Kosovë, përfaqësuesin e posaçëm të BE-së

dhe shefin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë. Më 13 nëntor 2024, Kryetarja Trendafilova u takua me anëtarë të shoqërisë civile në Kosovë dhe me gazetarë për t'iu dhënë informacion mbi proceset e DHSK-së dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të tyre.



Kryetare Ekaterina Trendafilova gjatë takimit në internet me shoqërinë civile në Kosovë, 13 nëntor 2024

Ne duhet të kujdesemi për personat që morën vendimin për të ardhur dhe për të dëshmuar para gjykatës. Njëra prej arsyeve për zhvendosjen, njëra prej arsyeve për këto elemente specifike, është që personat vërtetë të mbrohen, dhe që nga vizita ime e parë në Kosovë, gjithmonë kam thënë se as aktgjykimi më i mirë, aktgjykimi më i shkëlqyeshëm nuk do të kishte kurrfarë vlere nëse kjo do të bëhej në dëm të sigurisë së personave.

Kryetarja Trendafilova, takim në internet me shoqërinë civile të Kosovës, 13 nëntor 2024.

Më 27 nëntor 2024, Kryetarja vizitoi Brukselin, ku pati takime me disa ambasadorë të Komitetit Politik dhe të Sigurisë dhe me Zyrën e Drejtorit Administrativ për Evropën dhe Azinë Qendrore të Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm, z. Mati Masikas, komandantin e Operacioneve Civile, z. Stefano Tomat dhe anëtarë të Komitetit për Aspektet Civile të Administrimit të Krizave për të diskutuar çështje të rëndësishme për DHSK-në, duke përfshirë edhe nevojën e ngutshme për përfundimin e zbatimit të marrëveshjeve dypalëshe.

MARRËDHËNIET ME JASHTË

Marrëdhëniet me jashtë

Me shtimin e ndjeshëm të veprimtarive gjyqësore, Kryetarja dhe Administratorja kanë vazhduar të luajnë rol të rëndësishëm për t'i shpjeguar publikut në Kosovë dhe rajon si punon Gjykata për të garantuar procese gjyqësore të drejta, të sigurta dhe të efektshme, në përputhje me mandatin e saj dhe me standardet më të larta të së drejtës penale ndërkombëtare.

Nga 26 deri më 28 janar 2024, Kryetarja dhe Administratorja udhëtuan për në Sierra Leone, ku morën pjesë në një konferencë për trashëgiminë nga Gjykata e Specializuar e Sierra Leones, gjatë të cilës ato, ndër të tjera, diskutuan tema me rëndësi të përbashkët për DHSK-në.

Më 19 mars 2024, Kryetarja, Administratorja dhe Prokurorja e Specializuar u takuan në mjediset e DSK-së dhe ZPS-së me znj. Emili Rakhorst, zëvendëse e shefit të Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX).

Më 12 prill 2024, Kryetarja, Administratorja dhe Prokurorja e Specializuar mirëpritën në gjykatë shefin e EULEX-it dhe autoritetin emërues, gjeneralmajor Xhovani Pietro Barbano. Gjatë vizitës u diskutua për veprimtaritë gjyqësore aktuale të DSK-së dhe ZPS-së dhe për mbështetjen që jep EULEX-i në këtë drejtim.

Më 21 qershor 2024, Administratorja dhe Prokurorja e Specializuar mirëpritën në mjediset e DSK-së dhe ZPS-së, z. Edoardo Manfredini, shef i Seksionit Evropian për Politikë të Jashtme, Planifikim dhe Drejtim Civil.

Më 12 korrik 2024, të tre drejtueset e DSK-së dhe ZPS-së patën takime në DSK me gjeneralmajor Xhovani Pietro Barbano, shef i EULEX-it.

Më 4 shtator 2024, një përfaqësues i Kryetares, Administratores dhe Prokurores së Specializuar u takua në mjediset e DSK-së me znj. Emili Rakhorst, zëvendëse e shefit të EULEX-it.

Më 6 nëntor 2024, Kryetarja dhe Administratorja morën pjesë në një rishikim tematik mbi përfundimin e ciklit të drejtësisë të Mekanizmit Përmbyllës Ndërkombëtar për Tribunalët Penalë (MPNTP) që organizohej nga MPNTP-ja së bashku me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.

Më 8 dhjetor 2024, në kuadrin e raportimit vjetor, tre drejtueset përditësuan shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuuese me bazë në Hagë mbi veprimtarinë e DSK-së dhe ZPS-së.

Kryetarja dhe Administratorja mirëpritën gjithashtu në DSK edhe ambasadorë, autoritete ndërkombëtare dhe shtetërore, përfshirë edhe një numër të madh ambasadorësh të BE-së në Holandë; ambasadorin holandez për Organizatat Ndërkombëtare; Ministren Gjermane të Shtetit, Sh. e S. Katja Keul bashkë me delegacionin që e shoqëronte; Sh. e T. Erik Nusbaumer, kryetar i Këshillit Kombëtar Zviceran dhe delegacionin që e shoqëronte; një delegacion tjetër gjerman, një delegacion nga Filipinet; Kryesinë e Gjykatës Penale Ndërkombëtare; një delegacion juristësh nga Armenia, dhe një delegacion gjykatësish nga Ukraina.



Kryetarja Ekaterina Trendafilova me një delegacion juristësh nga Armenia, 2 korrik 2024



Kryetarja Trendafilova dhe Administratorja e DSK-së Fidelma Donlon me Sh. e T. Erik Nusbaumer, kryetar i Këshillit Kombëtar Zviceran, 1 tetor 2024



DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

VEPRIMTARITË KRYESORE 2024



Vazhduan gjykimet në 5 çështje gjyqësore me 13 të akuzuar



Aktgjykimi në 1 çështje gjyqësore



3 marrëveshje për pranimin e fajësisë



128 seanca publike në tri gjuhët e gjykatës



Dëshmuuan 72 dëshmitarë



Panelet lëshuan mbi 840 vendime dhe urdhra



Të përkthyer 864 dokumente me 11.509 faqe



Në tri çështje gjyqësore u pranuan 13 viktimat të merrnin pjesë në proces



92,000 shikime të faqeve me transmetime, më se 540 persona në Kosovë morën pjesë në aktivitete informimi publik për gjykatën

ZYRA ADMINISTRATIVE

Zyra Administrative

Zyra Administrative ofron shërbime për Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) nëpërmjet Seksionit të saj të Administratës dhe Seksionit të Shërbimeve Juridike. Në dhënien e shërbimeve, ajo është e paanshme dhe e pavarur. Zyra Administrative drejtohet nga Dr. Fidelma Donlon e cila këshillohet me Kryetaren dhe me Prokuroren e Specializuar për temat institucionale.

Në shërbimet administrative që i jep Zyra Administrative Dhomave dhe ZPS-së përfshihen buxheti, financimi, prokurimi, teknologjia e informacionit, administrimi i objektit, burimet njerëzore dhe siguria. Shërbimi i mbështetjes gjyqësore përfshin mbrojtjen dhe mbështetjen e dëshmitarëve, administrimin e Listës së Mbrojtësve, administrimin e sistemit të ndihmës juridike dhe të pjesëmarrjes së viktimave, si dhe shërbimet e përkthimit me shkrim dhe gojë, administrimin e Gjykatës dhe administrimin e objektit të paraburgimit të DHSK-së.

Gjatë vitit 2024, punonjësit e Zyrës Administrative, nën drejtimin e Administratores, vazhduan të japin shërbime të cilësisë më të lartë në mbështetje të menaxhimit të frytshëm administrativ të DHSK-së dhe ZPS-së, si edhe të procedurave të drejta, të sigurta dhe të efektshme në Gjykatë. Në to bënë pjesë edhe drejtimi i sistemit të miratimit paraprak dhe monitorimit të vizitave në objektin e paraburgimit të DHSK-së bazuar në vendimin e Trupit Gjykues, zbatimi i urdhrat të zhdëmtimit në çështjen Mustafa, shqyrtimi i kërkesave për ndihmë financiare dhe vlerësimi i ndihmës juridike, ruajtja e sigurisë dhe mirëqenies së dëshmitarëve, përkthimi i vendimeve dhe gjykimeve ligjore, lirimi me kusht i një të dyshuari, realizimi i dy vizitave nën ruajtje të paraburgosurve në Kosovë dhe transferimi i tre të akuzuarve në objektin e paraburgimit të DHSK-së pas arrestimit të tyre nga ZPS-ja në Kosovë. Gjithashtu, puna për komunikim dhe ndërgjegjësim ishte gjithmonë në qendër të vëmendjes për të vazhduar dialogun me njerëzit në Kosovë dhe me Rrjetin Informativ të Gjykatës, si edhe për të siguruar që informacionet e publikuara për gjykatën dhe proceset e saj të jenë të sakta.

Bashkimi Evropian (BE) është burimi kryesor i financimit për DHSK-në dhe ZPS-në. Ky financim jepet përmes marrëveshjeve dyvjeçare për subvencionime



Administratore Fidelma Donlon

të nënshkruara nga Administratorja në emër të DHSK-së e ZPS-së. Që prej vitit 2018 Zvicra jep financim shtesë për veprimtaritë e komunikimit dhe ndërgjegjësimin në Kosovë. Administratorja siguron administrimin e drejtë të burimeve financiare të DHSK-së dhe ZPS-së. Në përputhje me rregulloren qeverisëse, gjykata u nënshtrohet auditime financiare të brendshme dhe të jashtme. Deri në fund të vitit 2024, u kryen 20 auditime të jashtme në të cilat nuk u gjet asnjë parregullsi.

Në vitin 2024, bashkë me Kryetaren dhe Prokuroren e Specializuar, Administratorja ka bashkëpunuar me shtetet anëtare të BE-së dhe me shtetet e treta kontribuuese gjatë takimeve të informimit dhe atyre dypalëshe. Mbështetja nga shtetet është e domosdoshme për suksesin e gjykatës. Veçanërisht i rëndësishëm ka vazhduar të mbetet përfundimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit për zbatimin e dënimeve dhe mbrojtjen e dëshmitarëve.

Në DHSK ofrohet ndihmë juridike për të dyshuarit dhe të akuzuarit pa mjetet e mjaftueshme për të paguar mbrojtjen e tyre. Në fillim të vitit 2024, Administratorja kreu rishikimin e Rregullores për Ndihmë Juridike të DHSK-së, duke mundësuar dallimin mes pagesave maksimale të ndihmës juridike që mund të jepen në çështjet lidhur me krime ndërkombëtare dhe atyre lidhur me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë. Ndihma juridike vazhdoi të vendosej në bazë të fazës së procedurës, në vartësi se sa e ndërlikuar është çështja dhe sipas vlerësimit të varfërisë. Shumica e të akuzuarve në DHSK kanë zgjedhur të marrin ndihmë juridike vetëm nga qeveria e Kosovës.

Një ndër përparësitë strategjike të përcaktuara nga Administratorja është në fushën e menaxhimit dhe ruajtjes së dokumentacionit. Në vitin 2024, u përmirësua edhe më tej Regjistri i Aseteve Informative të DHSK-së. Në të përfshihen tani mbi 23TB materiale. Gjithashtu, u përpiluan dokumente me opsione për mënyrën se si mund të ruhen të sigurt duke qenë edhe të lehta në përdorim dokumentet administrative, ato të mbështetjes juridike dhe të dosjeve të çështjeve, duke parashikuar për të ardhmen një mekanizëm përmbyllës dhe krijimin e një arkivi.

Në vitin 2024, pas viteve pune përgatitore për përmirësimin e plotë të sistemit dhe transferimin e suksesshëm të të gjithë dokumentacionit në sistemin e përmirësuar, u kurorëzua puna e seksioneve në

sistemin elektronik të administrimit të gjykatës *Legal Workflow*. Në fund të vitit 2024 ishin përpunuar në sistem 10.120 parashtrime e vendime, si edhe 260.993 materiale të nxjerra. Vetëm në vitin 2024, në sistem u përpunuan 2.848 parashtrime e vendime, si edhe 4.332 materiale të nxjerra.

Gjatë vitit 2024, Zyra Administrative vazhdoi të bashkëpunojë ngushtë me shtetin pritës në lidhje me shërbimet që ai i jep DHSK-së sipas Marrëveshjes me Shtetin Pritës dhe marrëveshjeve të tjera të bashkëpunimit, si ajo për transferimin e të paraburgosurve, shërbimet e paraburgimit dhe në fushën e sigurisë. Mbështetja e dhënë nga Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë vazhdoi të ishte e rëndësishme për veprimtarinë e DHSK-së në Kosovë.

1

Kabineti i Administratores

Kabineti i Administratores (KA) ndihmon Administratoren për zbatimin e mandatit të saj. Zyra ka disa funksione, si mbështetja ligjore dhe joligjore në lidhje me procesin gjyqësor dhe administrimin e gjykatës, marrëdhëniet me shtetin pritës dhe ato diplomatike, marrëdhëniet me publikun dhe veprimtaritë e komunikimit e të ndërgjegjësimit, si edhe raportimin e drejtimin e shërbimeve protokollare. Pjesë e funksioneve të KA-së janë Administrimi i Informacionit (AdmInfo) dhe Siguria e Informacionit (SigInf).

Në vitin 2024, ekipi ligjor i KA-së dha këshilla ligjore për një mori çështjesh juridike, përfshirë edhe zbatimin e sistemit të ndihmës juridike të DHSK-së, kërkesat për ndihmë e bashkëpunim nga institucione të ndryshme, zbatimin e urdhrave të gjykatës dhe çështje të tjera operative. Ekipi ligjor mbështeti Administratoren veçanërisht në ndërtimin e sistemit efektiv për zbatimin e urdhrave të gjykatës në lidhje me ndryshimin e kushteve të paraburgimit dhe sigurimin e qasjes së efektshme për ndihmë juridike. Gjithashtu, ekipi ligjor dha mbështetje juridike për çështjet e lidhura në përgjithësi me administrimin e mirë, përfshirë burimet njerëzore. Në emër të Administratores, ekipi ligjor administroi 468 parashtrime në proceset gjyqësore të DHSK-së lidhur, mes të tjerash, me dhënien e efektshme të shërbimeve juridike, paraburgimin, ndihmën ligjore e mbrojtjen e dëshmitarëve.


Gjithashtu, KA-ja mbështeti Administratoren në përpjekjet e saj për të nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit me shtetet për zbatimin e dënimeve dhe mbrojtjen e dëshmitarëve.

Përgjegjësi e KA-së është edhe përgatitja dhe bashkërendimi i raporteve të DHSK-së, siç është edhe marrja e masave për protokollin e brendshëm. KA -ja drejton gjithashtu bashkëpunimin midis sektorëve për administrimin e dokumenteve dhe provave, ku përfshihet edhe kryerja me sukses e përmirësimit dhe transferimit të sistemit të administrimit të gjykatës dhe hapat e rëndësishme përpara në krijimin e arkivit të DHSK-së. Më konkretisht grupi i përkushtuar i punës për administrimin dhe ruajtjen e dokumenteve i bëri Administratores sugjerimet e nevojshme për zhvillimin e arkivit të DHSK-së, duke synuar ruajtjen afatgjatë të integritetit të përmbajtjes në përputhje me standardet ndërkombëtare. Veç kësaj, Administratores iu dhanë këshilla për mënyrën e transferimit në të ardhmen të dokumenteve dhe arkivit të DHSK-së në një mekanizëm ruajtës. Si pjesë e këtij projekti, AdmInfo kreu një rishikim të hollësishëm të Regjistrat të Aseteve Informative të DHSK-së duke konfirmuar edhe asetet fizike edhe ato elektronike, gjithsej 23TB dhe 229 metra lineare, për të mundur drejtimin e tyre nga Administratorja dhe përcaktimin e afateve të ruajtjes.

AdmInfo vazhdoi të ofrojë shërbime bibliotekare dhe ndihmë për punën kërkimore për një numër të të interesuarve. Në vitin 2024 u përmirësuan shërbimet bibliotekare të rrjetit të brendshëm të DHSK-së, për t'iu ofruar një përvojë më të mirë veçanërisht përdoruesve që punojnë nga larg. Gjithsej u morën dhe përpunuan 314 kërkesa për informacion kërkimor përmes fondit të brendshëm, bashkëpunimit të tij me Bibliotekën e Paqes dhe rrjetin e saj institucional.

SigInf dha këshilla dhe mbështetje për zhvillimin e politikave të administrimit të efektshëm të informacionit dhe për integrimin në DHSK të praktikave e standardeve më të mira të fushës.

Në vitin 2024, u përditësua administrimi i rrezikut për sigurinë e informacionit të DHSK-së dhe filloi zbatimi i projekteve për përmirësimin e sigurisë së informacionit dhe asaj kibernetike në të gjithë gjykatën. U kryen disa kontrole për sigurinë e informacionit në sistemet kyçe në mbështetje të veprimtarisë së gjykatës, duke përfshirë sistemin e përkthimeve *MultiTrans* dhe sistemin e administrimit elektronik të gjykatës *Legal Workflow*. Veç këtyre, SigInf mori hapa të mëtijshëm për rritjen e vetëdijes së personelit për sigurinë e informacionit dhe asaj kibernetike, duke përfshirë edhe përdorimin e platformës së trajnimit për sigurinë e informacionit të Shërbimit të Jashtëm Evropian, broshurave të rregullta dhe provave të imitimit të praktikave fishing.



Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun

Duke qenë se gjyqet zhvillohen në Hagë, DHSK-ja siguron që veprimtaritë e saj të ndërgjegjësimit dhe komunikimit t'i sjellin proceset gjyqësore në vazhdim sa më pranë publikut të gjerë dhe njerëzve në Kosovë përmes veprimtarive ndërvepruese të ndërgjegjësimit dhe komunikimit, një programi të plotë për vizitorët, angazhimeve të shpeshta me gazetarët, si edhe dhënies së informacionit në internet. Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun (NIKP) i prodhon të gjitha materialet në të tre gjuhët, shqipe, serbishte dhe anglishte.

Gjatë vitit 2024 pati zhvillime të rëndësishme të procedurave të DHSK-së që u ndoqën me vëmendje nga mediat kosovare dhe ato të rajonit. Transmetimi në internet i dëshmimeve të dëshmitarëve në çështjen *Hashim Thaçi dhe të tjerët*, si edhe shkëmbimet me shkrim përmes palëve, ishin burim i lajmeve thuajse të përditshme në Kosovë. Lëshimi në korrik 2024 i aktvendimit të dytë në çështjen e Pjetër Shalës, që përfshinte krime lufte, si edhe vendimet e Panelit të Gjykatës së Apelit për krimet e luftës në çështjen e z. Salih Mustafa në shtator 2024 nxitën gjithashtu interesin dhe pyetjet e medias dhe të publikut.

Gjithashtu, në shtator 2024 çështja *Januzi dhe të tjerët*, që ka lidhje me pengimin e drejtësisë, u kalua nga Procedura Paraprake te Trupi Gjyqësor I. Përpara se të planifikoheshin procedurat e gjykimit, tre të akuzuarit në këtë çështje dhe ZPS-ja arritën marrëveshje për

pranimin e fajësisë. Nga fundi i vitit 2024, hyri në fazën e gjykimit në procedurën paraprake Thaçi dhe të tjerët, një tjetër çështje për vepra penale që pretendohet se janë kryer kundër administrimit të drejtësisë.

Gjatë gjithë vitit, u mbajtën në mbarë Kosovën takime për komunikim dhe ndërgjegjësim, në të cilat përfaqësues të gjykatës iu përgjigjën pyetjeve dhe pjesëmarrësit shprehën pikëpamjet e tyre dhe mësuan drejtpërdrejt për veprimtaritë e DHSK-së. Gjithashtu gjykata vazhdoi të transmetojë videomateriale informative në stacionet kryesore televizive të Kosovës dhe të postojë rregullisht mbi proceset e saj në faqen e internetit dhe kanalet e rrjeteve sociale.

Me anë të programit për vizitorët, DHSK-ja iu ofroi grupeve të studentëve dhe profesionistëve të drejtësisë mundësinë për të vizituar mjediset publike, për të ndjekur seancat dhe për të marrë pjesë në prezantimet ndërvepruese. Në vitin 2024, u rrit ndjeshëm interesi për punën e gjykatës nga ana e studentëve ndërkombëtarë dhe profesionistëve të drejtësisë dhe gjatë këtij viti DHSK-ja mirëpriti në mjediset e saj 75 grupe. Në shtator 2024, DHSK-ja mori pjesë në Ditën e Hapur të Hagës, gjatë të cilës publiku u mirëpriti në mjediset e saj për të vizituar dhe mësuar rreth gjykatës.



Studentë vizitojnë DHSK-në, 29 tetor 2024

2.1 Mediat

Gjatë vitit 2024, NIKP-ja vazhdoi angazhimin e rregullt me median. Konferencat e përjavshme për shtyp në internet, të transmetuara njëkohësisht në të tri gjuhët e gjykatës, iu dhanë gazetarëve pjesëmarrës nga të gjitha anët e botës përditësime për procedurat, si edhe mundësinë për të bërë pyetje. Gjithashtu, zëdhënësit e DHSK-së iu përgjigjën 165 pyetjeve nga gazetarë të ndryshëm, duke dhënë sqarime brenda 24 orëve dhe dhanë 17 intervista më të gjata për mediat kosovare dhe rajonale.

Drejtuesit e DHSK-së mbeten gjithmonë të përkushtuar ndaj misionit të DHSK-së për komunikim të hapur me publikun rreth gjykatës dhe proceseve të saj dhe Kryetarja e DHSK-së dha tre intervista të gjata. Në nëntor 2024, Kryetarja bisedoi me shoqërinë civile dhe gazetarët në dy veprimtari në internet.

Mediat në Kosovë dhe kudo ndoqën nga afër zhvillimet në sallën e gjyqit. Në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* Prokuroria vazhdoi të paraqesë argumentet e saj dhe të thërrasë dëshmitarët për të dhënë prova. Megjithatë disa nga dëshmitë nuk ishin të hapura për publikun për shkak të domosdoshmërisë së mbrojtjes së viktimave, një numër i madh prej tyre u zhvilluan në seanca të hapura publike dhe mund të ndiqeshin në shqipe, serbishte dhe anglishte përmes transmetimit në faqen e internetit të DHSK-së. Përfaqësuesit e medias patën gjithashtu mundësinë të ndiqnin drejtpërdrejt seancat në mjediset e DHSK-së dhe të shfrytëzonin qendrën e mediave të ngritur posaçërisht për këtë në galerinë publike.

NIKP-ja u angazhua me mediat e interesuara në Kosovë dhe rajon, vazhdoi takimet me redaktorët kryesorë të lajmeve atje dhe e rriti edhe më tej numrin e tryezave të rrumbullakëta të organizuara nga zëdhënësit në Prishtinë. Gjatë vitit 2024 u realizuan gjashtë veprimtari të tilla në të cilat gazetarëve iu dha informacion i përgjithshëm si edhe mundësia për të pyetur. Gjithashtu, pas çdo takimi informativ, gazetarët u ftuan të bënin intervista audiovizuale me zëdhënësit e DHSK-së.



Zëdhënësi i DHSK-së Majkëll Doil në intervistën me
ATV Kosova



Zëdhënësjja e DHSK-së Anxhela Grip në intervistën me
Klan Kosova



Zëdhënësi i DHSK-së Majkëll Doil në një prej
takimeve informative në internet

2.2 Programi për komunikim dhe ndërgjegjësim

Bashkëbisedimi me njerëzit në Kosovë për mandatin e DHSK-së dhe proceset e saj ka qenë përparësi e DHSK-së që kur ajo u bë funksionale në aspektin gjyqësor në 2017. Me kalimin e kohës programi për komunikim dhe ndërgjegjësim i DHSK-së ka evoluar, gjithmonë duke mbajtur parasysh faktin që, me qenë se proceset zhvillohen jashtë Kosovës ekziston mundësia e krijimit të boshllëqeve informative dhe keqkuptimeve. Mësimet e nxjerra nga puna e tribunalëve të tjerë të zhvendosur kanë theksuar edhe më shumë nevojën e një programi të plotë për komunikim dhe ndërgjegjësim.

Që prej vitit 2018, në sajë të mbështetjes bujare të Zvicrës, DHSK-ja ka organizuar 185 veprimtari në të cilat janë kontaktuar 4.000 persona në Kosovë. Ekipet e komunikimit dhe ndërgjegjësimit udhëtojnë çdo muaj në Kosovë për të marrë pjesë në bashkëbisedime me studentë, përfaqësues të shoqërisë civile, grupe përfaqësuese të viktimave, gazetarë dhe të tjerë, në takime të organizuara në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile. Të gjitha veprimtaritë i janë përshtatur interesave të audiencës dhe janë ideuar për të nxitur diskutimin, në mënyrë që pjesëmarrësit të mund të shprehin pikëpamjet e tyre dhe të bëjnë

pyetje, dhe kjo ka rezultuar në veprimtari me interes dhe ndërvepruese. Sipas formularëve për marrjen e mendimeve në mënyrë anonime, 80% e pjesëmarrësve mendojnë se veprimtaritë janë informuese dhe 90% janë të interesuar të marrin pjesë përsëri.

Në vitin 2024, u mbajtën 29 veprimtari të programit për komunikim dhe ndërgjegjësim të DHSK-së, me praninë e 542 pjesëmarrësve në këto komunitete në Kosovë: Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicën e Veriut, Mitrovicën e Jugut, Lipjan, Hoçë e Madhe, Novobërdë, Shtërpçë, Llapllasellë; Ranillug; Zubin Potok; Graçanicë. Prej tyre, 27 ishin takime me prani fizike ndërsa dy u zhvilluan në internet.

Duke synuar kontaktin me një audiencë sa më të gjerë, DHSK-ja prodhon videomateriale shpjeguese për tema të tilla si mbrojtja e dëshmitarëve, pjesëmarrja e viktimave dhe për pyetje që bëhen shpesh në veprimtaritë e programit për komunikim dhe ndërgjegjësim. Në vitin 2024 gjykata vazhdoi transmetimin e këtyre videoeve në shqipe dhe serbishte për kanalet kryesore të televizionit në Kosovë dhe shfaqjen e tyre në kanalën YouTube, ku janë parë 3.900 herë gjatë vitit.



Veprimtari për komunikim dhe ndërgjegjësim, Mitrovicë e Veriut, Kosovë, 17 prill 2024

2.3 Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe Rrjeti i Informimit të Gjykatës

Dhomat e Specializuara të Kosovës këshillohen rregullisht me OJQ-të nga Kosova dhe Serbia me anë të Rrjetit të Informimit të Gjykatës (RRIGJ). Mendimet dhe sugjerimet e mara për përmirësimin e veprimtarive të komunikimit dhe ndërgjegjësimit janë të paçmuara dhe i kanë krijuar mundësi programit të komunikimit dhe ndërgjegjësimit që të zhvillohet me të njëjtat ritme si ato të gjykatës. OJQ-të pjesëmarrëse që veprojnë në fushat e drejtësisë kalimtare, të drejtave të njeriut, rinisë dhe minoriteteve sjellin të gjitha një këndvështrim të ndryshëm për nevojat dhe interesat e komuniteteve përkatëse dhe për mënyrën se si mund t'i përcillen një audience të gjerë tema ligjore që nganjëherë janë teknike.

Në tetor 2024, gjykata organizoi në Prishtinë një takim me përfaqësuesit e RRIGJ-së, në të cilin u diskutuan çështje të ndryshme, ndër të cilat edhe se si DHSK-ja mund t'i shpjegonte çështje të ndërlikuara juridike një audience që nuk është e fushës. Gjithashtu, DHSK-ja organizoi dy takime në internet me përfaqësues të RRIGJ-it për tërheqjen e mendimeve rreth kanaleve të DHSK-së në median sociale dhe videomaterialeve shpjeguese. Në dhjetor 2024, Administratorja e DHSK-së bëri një takim në internet me anëtarë të RRIGJ-it për t'iu dhënë OJQ-ve partnere të gjykatës përditësim mbi zhvillimet më të rëndësishme të kohëve të fundit.



Administratorja Fidelma Donlon dhe zëvendësadministratori Jonas Nilson gjatë një takimi në internet me anëtarë të Rrjetit Informativ të Gjykatës, 12 dhjetor 2024

2.4 DHSK-ja në internet

I gjithë informacioni publik për kornizën ligjore, veprimtarinë dhe proceset e DHSK-së është i publikuar në faqen e internetit të DHSK-së në shqipe, serbishte dhe anglishte dhe është i lehtë për t'u kuptuar dhe për t'u gjetur. Seancat publike transmetohen në internet në tri gjuhët e gjykatës, ndërkohë që mbi 6.000 parashtrime publike të çështjeve të ndryshme gjyqësore mund të shfrytëzohen përmes arkivit elektronik të dokumentacionit gjyqësor publik në faqen e internetit të DHSK-së. Kjo faqe interneti përmban përditësim të drejtpërdrejtë që përmbledh zhvillimet më të rëndësishme ditore të çështjeve gjyqësore, si edhe material informues, si për shembull të dhëna faktike, grafika informative dhe njoftime në lidhje me gjykatën.

Në vitin 2024, faqja e transmetimit në internet vazhdoi të ishte faqja më e kërkuar duke arritur 92000 shikime. Në tërësi, në vitin 2024, faqja e DHSK-së në internet arriti 791000 shikime, pjesa më e madhe e të cilave ishin nga Holanda, Kosova dhe Serbia.

Krahas regjistrimeve nga seancat publike, gjykata poston në kanalin e saj të YouTube videomateriale për pyetje që bëhen shpesh, bazat e mandatit të saj, si edhe regjistrime të seancave publike. Gjatë vitit 2024 kanali në YouTube pati mbi 660 abonentë dhe u vizitua 39.400 herë, me një kohëzgjatje të përgjithshme shikimi prej 3.800 orësh. Videoja më e shikuar ishte dita e parë e deklaratave hyrëse në çështjen gjyqësore Thaçi dhe të tjerët, që u zhvillua në prill 2023.

Në vitin 2023, DHSK-ja çeli llogari në X (dikur Twitter) në të tri gjuhët e gjykatës. Në vitin 2024, DHSK-ja postoi rregullisht mbi zhvillimet e gjyqeve, veprimtaritë e saj të komunikimit dhe ndërgjegjësimit dhe mënyrën se si DHSK-ja ushtron drejtësinë. Gjikata ka mbi 1.100 ndjekës në mediat sociale. Në vitin 2024, DHSK-ja filloi postimin e përmuajshëm të videove në të cilat përmbledheshin zhvillimet më të rëndësishme në proceset gjyqësore si edhe video me përditësime nga misionet e saj të komunikimit dhe të ndërgjegjësimit në Kosovë.





Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore ofron mbështetje juridike dhe operative për Gjykatën dhe palët në proceset gjyqësore përmes Njesisë për Administrimin e Gjykatës, Njesisë së Përkthimit, Zyrës së Mbrojtjes, Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave, Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve dhe Njesisë së Paraburgimit.

Në vitin 2024, DHSK-ja shënoi arritje të mëtjshme, me shqiptimin e aktgjykimit të dytë për krime lufte para DHSK-së, dhe vendimin e Panelit të Gjykatës Supreme pas të cilit Paneli i Apelit lëshoi një dënim të ri. Gjithashtu, filluan procedurat paraprake në një çështje lidhur me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe u paraqitën marrëveshje për pranimin e

fajësisë në një tjetër. Gjatë këtij viti, numri i të paraburgosurve në objektin e paraburgimit të DHSK-së shkoi nga dhjetë në nëntë, pas lirim të një të dyshuari nën kushte të rrepta në Kosovë. Pas arrestimeve të dhjetorit të vitit 2024, në fund të vitit numri i të paraburgosurve u rrit në 12.

Njësitë e Seksionit të Shërbimeve Gjyqësore ofruan mbështetje të gjerë për dëshmitarët, siç është mbrojtje për dëshmitarët dhe mbështetje psikologjike, dhe garantuan përfaqësimin ligjor dhe dhënien e ndihmës juridike. Seksioni siguroi kushte të sigurta të paraburgimit për të paraburgosurit në objektin e paraburgimit të DHSK-së.

3.1 Njësia për Administrimin e Gjykatës

Si përgjegjëse për dokumentacionin e çështjeve gjyqësore, Njësia për Administrimin e Gjykatës (NJAGJ) administron përpunimin dhe shpërndarjen e të gjithë dokumentacionit të çështjeve gjyqësore përmes sistemit elektronik Legal Workflow të administrimit të Gjykatës në DHSK. NJAGJ-ja ka edhe përgjegjësi të tjera në lidhje me administrimin e seancave gjyqësore, përfshirë transkriptimin e seancave përmes programit informatik të transkriptimit Transcend, si dhe administron një arkiv fizik të posaçëm të provave materiale.

Në vitin 2024 u mbajtën 130 seanca gjyqësore. Në bashkërendim me Zyrën për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve, NJAGJ-ja mbështeti familjarizimet me sallën e gjyqit për 72 dëshmitarë dhe kontribui në dhënien e 19 dëshmime nga distanca nëpërmjet lidhjes me video. NJAGJ-ja përpunoi dhe shpërndau 710 transkripte të këtyre seancave në tri gjuhët zyrtare të Gjykatës. U zbatuan gjithsej 91 urdhra për redaktime në sallën e gjyqit ose pas seancës. Gjithashtu, pas lëshimit të urdhrave dhe vendimeve, u riklasifikuan, përpunuan dhe rishpërndanë 282 transkripte me mbi 31.020 faqe.

Gjatë vitit u botuan 373 transkripte në bazën e të dhënave të dokumentacionit gjyqësor publik në faqen e internetit të DHSK-së. Gjatë 2024-ës, NJAGJ-ja mori, përpunoi dhe shpërndau gjithsej 2.848 parashtime të protokolluara me 1.164 shtojca. Gjithashtu, ajo përpunoi dhe shpërndau gjithsej 495 dokumente letërkëmbimi.

Në vitin 2024, NJAGJ-ja përpunoi 68.000 faqe parashtime nëpërmjet sistemit elektronik të administrimit të Gjykatës Legal Workflow.

Gjithsej, në bazën e të dhënave të dokumentacionit gjyqësor publik në faqen e internetit u bënë të disponueshme 1.527 parashtrime.

Gjithashtu, pas lëshimit të urdhrave nga panelet, u riklasifikuan, përpunuan dhe rishpërndanë mbi 327 parashtrime. Gjithsej, nëpërmjet sistemit u përpunuan mbi 5.600 kërkesa përkthimi dhe mbi 4.300 dokumente me kapacitet të përgjithshëm prej 150GB u nxorën për palët.

Platforma bazë e sistemit Legal Workflow të DHSK-së u përtëri në prill 2024 dhe vazhdoi të përmirësohej për të krijuar mjetet e nevojshme teknologjike për lehtësimin e nevojave të përdoruesve dhe për të përmirësuar funksionimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit, duke pasur parasysh përdorimin e shtuar të tij. U bënë përgatitje për instalimin në vitin 2025 të një sistemi të ri transkriptimi.

3.2 Njësia e Përkthimit

Në vitin 2024, Njësia e Përkthimit vazhdoi të bëjë përkthime me gojë dhe me shkrim si në selinë e gjykatës, ashtu edhe në kuadër të misioneve.

Gjatë këtij viti, NJP-ja përktheu më se 11.500 faqe nga versionet origjinale. Përkthimet u bënë në gjuhët shqipe, serbishte dhe anglishte, si dhe në gjuhë të tjera, në shërbim të efektivitetit të punës, funksionimit të papenguar të gjykatës dhe komunikimeve të jashtme të saj. Këto përkthime kanë përfshirë parashtrime të shumta, informimet javore për mediat, njoftimet për shtyp dhe materiale të tjera informuese dhe ndërgjegjësuese, raporte të Avokatit të Popullit dhe korrespondencën me palë të jashtme. Ndër dokumentet juridike, përkthimet kryesore kanë qenë aktgjykimi i apelit në çështjen Mustafa, vendimi për dënimin e ri të z. Mustafa dhe aktgjykimi i dhënë në çështjen Shala.

Gjatë periudhës në fjalë, NJP-ja ofroi shërbime të përkthimit simultan për 130 seanca gjyqësore në faza të ndryshme të proceseve, përfshirë fazën paraprake, të gjyqimit dhe të apelit. Njësia ofroi gjithashtu dhe përkthimin simultan për 47 informime javore për median si dhe shërbime përkthimi simultan dhe konsektiv në takimet dhe mbledhjet e mbajtura në selinë e DHSK-së dhe gjatë misioneve jashtë vendit. Krahas kësaj, NJP-ja u ofroi mbështetje njësisë të tjera në lidhje me kërkesat *ad hoc* për shërbime përkthimi me gojë, me shkrim apo ndihmë tjetër gjuhësore.

Gjatë vitit 2024, NJP-ja përktheu mbi 864 dokumente në gjuhët zyrtare të gjykatës dhe në gjuhë të tjera, sipas kërkesave.



3.3 Zyra e Mbrojtjes

Zyra e Mbrojtjes (ZM) administron sistemin e ndihmës juridike për përfaqësimin e të dyshuarve dhe të akuzuarve të varfër ose zotërojnë pjesërisht të varfër. ZM-ja gjithashtu administron sistemin e përfaqësimit juridik. Gjithashtu, së bashku me Zyrën e Pjesëmarrjes së Viktimave, ZM-ja administron Listën e Mbrojtësve që përmban 241 mbrojtës, prej të cilëve 127 ishin mbrojtës të specializuar, 28 ishin mbrojtës të viktimave dhe 86 kishin të drejtë të ishin mbrojtës të specializuar dhe mbrojtës të viktimave. Procesi i parashtrimit të kërkesave për pranim në Listë mbetet i hapur.

Si njësi e Zyrës Administrative, ZM-ja është e paanshme. Ajo është pika e kontaktit për çdo çështje administrative të ekipet e mbrojtjes mund të kenë me Zyrën Administrative. Njësia u ka dhënë udhëzime ekipeve të mbrojtjes për një sërë çështjesh, ku përfshihen pranimi i anëtarëve në ekipet e mbrojtjes në përputhje me Direktivën për Mbrojtësit dhe regjistrimi i tyre në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Holandës, si dhe lehtësimin e njohjes së mjediseve të DHSK-së dhe sistemeve të DHSK-së, veçanërisht të sistemit elektronik të administrimit të Gjykatës *Legal Workflow*. Në lidhje me këtë, ZM-ja bashkëpunon me njësitë përkatëse të Zyrës Administrative.

Deri në fund të vitit, ishin 16 ekipe të Mbrojtjes, me personel gjithsej 168 persona, përfshirë 16 mbrojtës të specializuar. Katër prej këtyre ekipeve u financuan nga sistemi i ndihmës juridike të DHSK-së.

Sistemi i ndihmës juridike në DHSK u ofrohet të dyshuarve dhe të akuzuarve të cilët vërtetojnë se nuk janë në gjendje të paguajnë përfaqësimin juridik. Megjithatë DHSK-ja ka marrë disa kërkesa për ndihmë juridike në të shkuarën, gjatë vitit 2024 u miratuan me kusht kërkesat e para dhe u bënë pagesat për ndihmë juridike. Kushtëzimi lidhet me përfundimin e hetimeve dhe vlerësimeve të varfërisë.

Një tjetër aspekt i detyrave të Njesisë është sigurimi i qasjes në shërbimet e mbrojtësit kujdestar kur kërkohet gjatë procedurave ligjore. ZM-ja gjithashtu lehtëson komunikimin ndërmjet ekipeve të mbrojtjes dhe shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve të tjera, në lidhje me kërkesat hetimore të ekipeve të mbrojtjes.

Në vitin 2024, ndihmën juridike të DHSK-së e kërkoi një numër më i madh i të akuzuarve.



3.4 Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave

Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave (ZPV) administron sistemin e pjesëmarrjes së viktimave në DHSK duke u ofruar ndihmë personave që dëshirojnë të marrin pjesë në proces si viktimat, duke përpunuar kërkesat e tyre dhe duke ua dorëzuar ato trupit gjykues përkatës.

Pasi pranohen si viktimat pjesëmarrëse në proceset para DHSK-së, ZPV-ja u siguron atyre përfaqësimin e duhur. Për këtë qëllim, ZPV-ja zotëron një listë të mbrojtësve, e cila përmban 114 mbrojtës të kualifikuar për të përfaqësuar viktimat. ZPV-ja administron gjithashtu sistemin e ndihmës juridike për viktimat pjesëmarrëse.

Viktimat që marrin pjesë në proceset gjyqësore gëzojnë të drejtat për njoftim, pranim dhe zhdëmtim. Ato i ushtrojnë këto të drejta përmes mbrojtësit të viktimave, i cili caktohet për një grup viktimash në secilën çështje gjyqësore. Mbrojtësi i viktimave mund të jetë i pranishëm në seancat gjyqësore, të bëjë parashtrime me gojë dhe me shkrim dhe i mban viktimat të informuara gjatë gjithë procesit.

Tre procese gjyqësore para DHSK-së kanë viktimat pjesëmarrëse dhe afatet përkatëse për aplikime kanë përfunduar për të tri proceset.

ZPS-ja ka marrë gjithsej 322 aplikime dhe ka dorëzuar 24 raporte, përfshirë aplikimet e viktimave për panelet përkatëse. Që nga viti 2020, statusi i viktimës pjesëmarrëse para DHSK-së është miratuar për 170 aplikues: tetë në çështjen kundër z. Shala, tetë në çështjen kundër z. Mustafa dhe 154 në çështjen kundër z. Thaçi dhe të tjerëve.

Në çështjen kundër z. Mustafa, Trupi Gjyqës I lëshoi urdhrin e parë për zhdëmtim në vitin 2023, duke urdhëruar z. Mustafa të paguajë shumën prej gjithsej 207.000 eurosh si kompensim për dëmin e shkaktuar tetë viktimave pjesëmarrëse.

Gjatë vitit 2024 u ndërmorën disa hapa për zbatimin e urdhrin për zhdëmtim. Pas caktimit nga Kryetarja të Gjykatësit të Vetëm për mbikëqyrjen e zbatimit të urdhrin nga Administratorja, janë bërë një sërë parashtrimesh dhe raportesh dhe janë marrë vendime për të zbatuar urdhrin.

Konkretisht, Gjykatësi i Vetëm lëshoi urdhëra lidhur me mjetet e mundshme financiare të z. Mustafa të cilat të përdorëshin për zbatimin e pjesshëm të urdhërit në bazë të pagesave përpjestimore për viktimat. Gjykatësi i Vetëm rikujtoi gjithashtu se ky zbatim i pjesshëm i urdhrin për zhdëmtim nuk e liron z. Mustafa nga detyrimi për të paguar të plotë shumën, edhe pse aktualisht nuk është në gjendje ta bëjë.

Në fund të vitit 2024, Trupi Gjyqës I lëshoi urdhrin e tij të dytë për zhdëmtim, duke urdhëruar z. Shala të paguajë shumën prej 208.000 eurosh si kompensim për dëmin fizik, mendor dhe material të shkaktuar tetë viktimave të krimeve për të cilat u dënua. Ashtu si në çështjen Mustafa, Trupi Gjyqës urdhëroi Administratoren për zbatimin e urdhrin dhe që, në bashkërendim me mbrojtësin e viktimave, të kërkojë kompensim për viktimat e çështjes nga Programi për Kompensimin e Viktimave të Krimeve në Kosovë.

Si në çështjen Mustafa ashtu dhe në çështjen Shala, Trupi Gjyqës konstatoi se personat e dënuar nuk zotërojnë mjete financiare, prandaj Trupi Gjyqës ftoi dhe aktorë të tjerë të përfshihen në pagimin e zhdëmtimeve. Trupi Gjyqës rikujtoi detyrimin e Kosovës për të mbështetur viktimat në këtë drejtim, por gjithashtu i rekomandoi DHSK-së mundësinë e lejimit të kontributeve vullnetare. Pas miratimit nga Administratorja të kuadrit ligjor përkatës, ekziston mundësia e marrjes së donacioneve vullnetare dhe të pakushtëzuara, si kontribute për pagimin e zhdëmtimeve që u akordohen viktimave me një urdhër për zhdëmtim të lëshuar nga Dhomat e Specializuara.

Që prej vitit 2020, statusi i viktimës pjesëmarrëse u është miratuar 170 personave para DHSK-së.

3.5 Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve

Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD) është përgjegjëse për mbrojtjen e sigurisë, mirëqenies fizike dhe psikologjike, dinjitetit dhe privatësisë së dëshmitarëve dhe viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore.

Gjatë vitit 2024, ZMMD-ja vazhdoi të ofronte ndihmë dhe mbështetje për dëshmitarët që dëshmuan para DHSK-së. Prej 72 dëshmitarëve, 19 dëshmuan përmes lidhjes me video dhe 43 dëshmitarë dëshmuan me masa mbrojtëse në sallën e gjyqit.

ZMMD-ja organizoi udhëtimet e dëshmitarëve në bashkëpunim të ngushtë me vendin pritës dhe autoritetet e tjera përkatëse. Para paraqitjes në gjyq, dëshmitarët u informuan nga ZMMD-ja për mbështetjen që do të merrnin lidhur me paraqitjen në gjyq, përfshirë lidhur me paraqitjen e tyre, sigurinë dhe mirëqenien, me rolin, të drejtat dhe detyrat si dëshmitarë dhe me çështje praktike të paraqitjes në gjyq dhe qëndrimit. Gjatë vitit 2024, pas vlerësimit të sigurisë dhe nevojave të tjera, ZMMD-ja shoqëroi 25 dëshmitarë. Para paraqitjes së tyre në gjyq, dëshmitarët u familjarizuan me sallën e gjyqit dhe procedurat e seancave. Gjatë qëndrimit në vendin e dëshmisë, dëshmitarët morën ndihmën dhe mbështetjen e përshtatshme nga ZMMD-ja, përfshirë praninë e vazhdueshme të ekipit mbështetës të ZMMD-së.

Mbështetje psikologjike u është ofruar nga psikologë të ZMMD-së para, gjatë dhe pas dëshmisë për të garantuar mirëqenien e dëshmitarëve gjatë gjithë procesit dhe për të pakësuar rrezikun e traumave të reja gjatë dëshmisë. Nëse miratohej nga dëshmitari, janë bërë vlerësimet e nevojave për mbështetje lidhur me mirëqenien, mjekësore dhe të tjera. Dëshmitarët posaçërisht të cenueshëm, përfshirë dëshmitarët viktimë si dhe dëshmitarët me nevoja të veçanta, kanë raportuar se ishin shumë të kënaqur me shërbimet e përgatitura veçanërisht për secilin person.

Këto shërbime kanë përfshirë rekomandimin e masave të veçanta ose mbrojtëse në sallën e gjyqit për të garantuar sigurinë e dëshmitarëve të cenueshëm dhe për të mbrojtur dinjitetin dhe privatësinë e tyre gjatë gjithë procesit gjyqësor. Trupat Gjyqësor kompetentë i kanë miratuar këto masa.

Oficerët e mbrojtjes të ZMMD-së trajtuan gjithashtu nevojat e sigurisë së dëshmitarëve që përfunduan dëshminë, kur ishte e përshtatshme në bashkëpunim me palën thirrëse, dhe u ofruan mbrojtje të veçantë dëshmitarëve dhe familjeve për të cilët u vlerësua se ishin në rrezik për shkak të dëshmive të tyre. Për të garantuar sigurinë e tyre, ZMMD-ja u ofroi masa mbrojtëse të përgatitura veçanërisht për dëshmitarët, viktimat dhe personat mbështetës shoqëruar, para, gjatë dhe pas dëshmisë së tyre.

Në përpjekje për ruajtjen e identitetit të dëshmitarëve të mbrojtur, ZMMD-ja këshilloi gjithashtu trupat gjyqësor mbi redaktimin nga dokumentacioni i gjyqit të informacionit që mund të zbulonte identitetin e dëshmitarëve apo të komprometonin dinjitetin dhe privatësinë e tyre. Për më tepër, ZMMD-ja rishikoi transkriptet e dëshmive të dhëna në seanca private për t'u siguruar ruajtja e integritetit të masave mbrojtëse të urdhëruara nga gjykata, si dhe mbështetja e objektivave të gjykatës për transparencë dhe kryerjen e proceseve publike.

ZMMD-ja garantoi që dëshmitarët e paraqitur për të dëshmuar kishin marrë këshillat e duhura lidhur me sigurinë dhe mund të ngrinin çdo shqetësim lidhur me sigurinë me oficerët e mbrojtjes të ZMMD-së. ZMMD-ja vazhdoi të punonte në bashkëpunim të ngushtë me partnerët përkatës në Kosovë dhe rajon, me shtetin pritës dhe në shkallë ndërkombëtare për përmbytjen e mandatit të saj për garantimin e sigurisë së dëshmitarëve që u paraqitën para DHSK-së.

Në vitin 2024, ZMMD-ja pati 272 kontakte të dëshmitarëve me psikologun.

3.6 Njësia e Paraburgimit

Njësia e Paraburgimit (NJP) drejton dhe administron objektin e paraburgimit të DHSK-së që gjendet në mjediset e një burgu holandez në Hagë. NJP-ja garanton mbajtjen e sigurtë të të paraburgosurve. Njësia ka respekt të plotë për dinjitetin dhe të drejtat e të gjithë të akuzuarve në përputhje me Rregulloren e Paraburgimit të DHSK-së (Rregullorja), praktikat më të mira dhe të gjitha standardet ndërkombëtare përkatëse. Pas lirimit me kusht të z. Isni Kilaj në Kosovë në maj të vitit 2024 dhe arrestimeve në dhjetor të atij viti, në fund të vitit 2024 në objektin e paraburgimit ishin 12 të paraburgosur.

Në përputhje me parimet e gjykimit të drejtë, DHSK-ja është e angazhuar t'u sigurojë të paraburgosurve kohën dhe mjetet e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes së tyre. Si pjesë e këtij angazhimi dhe e fillimit të procedurave të gjykimit për një çështje në gjykim dhe një tjetër në procedurë paraprake, NJP-ja organizoi vizita të mbrojtësve, personale ose nëpërmjet videolidhjes, në bazë të kërkesave dhe në pajtim me Rregulloren. Të paraburgosurit vazhduan të ndjekin në distancë procesin nga objekti i paraburgimit pas autorizimit të trupit gjykues përkatës.

Mundësia për ruajtjen e marrëdhënieve personale me familjen dhe miqtë u krijua nga NJP-ja nëpërmjet vizitave personale dhe nëpërmjet videos. Pas urdhërit të dhjetorit 2023 nga Trupit Gjykes në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* për disa kufizime për vizitat, komunikimet telefonike dhe korrespondencën e tre prej të akuzuarve të kësaj çështjeje, në fillim të vitit 2024 NJP-ja vuri në zbatim një sistem të ri vizitash për të gjithë të paraburgosurit. NJP-ja vazhdoi të siguronte respektimin e të drejtës së të paraburgosurve për të komunikuar me të afërm dhe miq.

Të paraburgosurit vazhduan të përfitojnë nga standardet më të larta të kujdesit shëndetësor, me qasje në shërbimet e kujdesit shëndetësor për të siguruar vazhdimin e trajtimit dhe kujdesit.

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) dhe Avokati i Popullit i DHSK-së zhvillon inspektime të pavarura të objektit të paraburgimit të DHSK-së për t'i vlerësuar kushtet e paraburgimit. Në vitin 2024, KNKK-ja kreu një inspektim dhe Avokati i Popullit kreu tri inspektime.



Objekti i paraburgimit i DSHK-së

Gjatë vitit 2024, NJP-ja administroi mbi 552 vizita personale nga familjarët dhe vizitorë të tjerë në objektin e paraburgimit të DSHK-së.

Seksioni i Administratës ofron ekspertizë dhe mbështetje administrative e teknike për DHSK-në dhe ZPS-në përmes Njesisë së Burimeve Njerëzore, Njesisë së Teknologjisë së Informacionit, Njesisë për Administrimin e Objekteve dhe Shërbimet e Përgjithshme, Njesisë së Sigurisë, Njesisë së Financave dhe Buxhetit dhe Njesisë së Prokurimit.

Në vitin 2024, puna e seksionit u përqendrua në lehtësimin e procedurave gjyqësore duke mundësuar pjesëmarrjen në seanca nga distanca, mbështetjen e aplikacionit kryesor të gjykatës *Legal Workflow* nëpërmjet të cilit përpunohet dhe shpërndahet i gjithë dokumentacioni i DHSK-së, zbatimin e vendimeve të Gjykatës të Procedurës Paraprake, Gjykatës të Vetëm dhe paneleve për kryerjen e vizitave nën ruajtje të personave të paraburgosur në Kosovë për arsye humanitare, transferimin e të akuzuarve në objektin e paraburgimit të DHSK-së pas arrestimeve në Kosovë, si dhe përcaktimin, së bashku me policinë e Kosovës, të procedurave për monitorimin dhe raportimin mbi personat që shërbejnë dënime të ndryshuara ose nën

kufizime ligjore në përputhje me vendimet përkatëse gjyqësore.

Si pjesë e angazhimit të DHSK-së për miradministrimin e burimeve njerëzore dhe financiare, shefi i Seksionit të Administratës dhe shefi i Njesisë së Financave dhe Buxhetit vunë në zbatim një sistem për parashikimin e shpenzimeve mujore në nivel njësie. Gjithashtu, u organizuan trajnime të fokusuara në të gjithë DHSK-në për përmirësimin më tej të përdorimit efektiv të burimeve dhe për të siguruar zbatimin e rreptë të buxhetit të DHSK-së për periudhën 15 qershor 2023 - 14 qershor 2025.

Shefi i Seksionit të Administratës, në cilësinë e personit të kontaktit kundër mashtrimeve, së bashku me audituesen e brendshme dhe një punonjës të Seksionit të Administratës, vazhduan zbatimin e planit të veprimit të DHSK-së kundër mashtrimit dhe organizuan trajnime ndërgjegjësuere kundër mashtrimit për punonjësit e DHSK-së dhe ZPS-së.

4.1 Njësia e Burimeve Njerëzore

Njësia e Burimeve Njerëzore (NJB NJ) ofron mbështetje, këshilla dhe shërbime për të gjithë punonjësit e DHSK-së dhe ZPS-së. NJBNJ-ja vazhdoi kryerjen e detyrave të saj përmes ofrimit të ndihmës në procesin e rekrutimit dhe përzgjedhjes së punonjësve, administrimit dhe këshillimit të tyre për një sërë çështjesh të personelit, që nga kompensimet dhe përfitimet, deri tek aspekte të mirëqenies dhe sigurimit shëndetësor, ofrimit të mbështetjes për punonjësit dhe drejtuesit gjatë procesit të rinovimit të kontratave, vlerësimit të punës së punonjësve dhe ofrimit të mundësive për zhvillimin profesional dhe të njohurive të punonjësve.

Në vitin 2023 u mbyllën dy ftesa për aplikime për vende pune dhe dy ftesa për praktikë profesionale.

Për ftesat për vende pune, u dorëzuan gjithsej 767 aplikime nga 360 aplikantë. Prej tyre, 121 ishin femra dhe 239 meshkuj, dhe 89% ishin nga shtete anëtare të BE-së ndërsa 11% nga shtete të treta kontribuuese.

Ftesa e parë për praktikë profesionale e vitit solli 332 aplikime nga 118 kandidatë, prej të cilëve 76 ishin femra dhe 42 meshkuj. Ftesa e dytë solli 287 aplikime nga 102 kandidatë, prej të cilëve 74 ishin femra dhe 28 meshkuj. Shtatëmbëdhjetë praktikantë gjithsej, prej të cilëve 15 femra dhe dy meshkuj, iu bashkuan DHSK-së dhe ZPS-së gjatë vitit 2024. Gjithashtu, 12 emërime/studentë vizitorë iu bashkuan DHSK-së dhe ZPS-së si pjesë e projekteve kërkimore akademike të tyre.

Në vitin 2024, filluan punë 40 punonjës të rinj, prej të cilëve 19 femra dhe 21 meshkuj. Gjithashtu, 25 kandidatë të brendshëm arritën të merrnin pozicionet e reja të njoftuara në thirrjet për aplikim të vitit 2024.

Personeli i gjithsejtë i DHSK-së dhe ZPS-së u rrit nga 282 më 31 dhjetor 2023 në 293 më 31 dhjetor 2024. Prej 210 punonjësve në DHSK, 102 ishin femra dhe 108 meshkuj, dhe nga 83 punonjës në ZPS, 37 ishin femra dhe 46 meshkuj.

Numri i punonjësve të emëruar për punësim nga shtetet anëtare për pjesën më të madhe të vitit 2024 ishte 12, por zbriti në 10 në fund të vitit. Prej tyre, tetë ishin nga vende anëtare të BE-së Bullgaria, Gjermania, Hungaria dhe Irlanda, ndërsa dy ishin nga shtete të treta kontribuese Zvicra dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Me qëllim forcimin e mbështetjes së NJBNJ-së për punonjësit, u bënë përmirësime të mëtejshme në ofrimin e shërbimeve administrative për punonjësit, veçanërisht në fushën e regjistrimit të lejeve dhe mbështetjes së punonjësve gjatë lejeve për arsye shëndetësore, me qëllim riintegrimin e suksesshëm në punë pas një mungese të gjatë. Paralelisht, u përgatitën dhe ofruan udhëzues të brendshëm të përmirësuar dhe takime informuese për të drejtat për të lehtësuar dhënien e një informacioni gjithëpërfshirës dhe të udhëzimeve për punonjësit e rinj dhe ata ekzistues.

NJBNJ-ja vazhdoi të organizojë takime informuese për punonjësit e rinj, mundësi për zhvillimin profesional dhe të njohurive për të gjithë punonjësit me tema si parandalimi i ngacmimit psikologjik dhe seksual, administrimi i punës, drejtimi dhe administrimi dhe mirëqenia e punonjësve.

Me mbështetjen e vazhdueshme të drejtuesve të lartë për të nxitur një mjedis pune të sigurt, në frymë respekti dhe pa asnjë formë ngacmimi, NJBNJ-ja organizoi takime të detyrueshme për drejtuesit e njësive me temën 'Si të Trajtohen Pretendimet për Ngacmim në një Mjedis Pune Mbështetës' në vitin 2024, ku pjesëmarrja ishte 85%. Punonjësit gjithashtu u informuan përsëri për shërbimet e mbështetjes të brendshme dhe të jashtme, përfshirë psikologun këshillues dhe këshilltarin e DHSK-ZPS-së për mirëqenien.


Si pjesë e programit të mirëqenies dhe në përkujtim të Javës së Ndërgjegjësimit për Shëndetin Mendor në maj 2024 dhe Ditës Botërore të Shëndetit Mendor në 10 tetor 2024, NJBNJ-ja organizoi një sërë aktivitete dhe prezantimesh mbi temat përkatëse dhe zhvilloi më tej faqen e dedikuar mirëqenies në intranet, duke u mundësuar punonjësve qasje të lehtë tek burimet mbi shëndetin mendor.

Në bashkëpunim me Njësinë e Financës dhe Buxhetit, NJBNJ-ja ofroi mbështetje për tranzicionin e administrimit të fondit të pensionit dhe bashkërendoi mbylljen me sukses të modelit të mëparshëm të administrimit, duke u dhënë informacione të sakta dhe aktuale punonjësve pjesëmarrës.

Në fund të vitit 2024, DHSK-ZPS-ja kishin gjithsej 293 punonjës.




Numri i gjithsejtë i punonjësve të DHSK-së dhe ZPS-së



Përfaqësimi i punonjësve në DHSK dhe ZPS sipas shteteve

31 dhjetor 2024



4.2 Njësia e Teknologjisë së Informacionit

Njësia e Teknologjisë së Informacionit (NJTI) mbështeti me shërbime 130 ditë seancash, gjatë të cilave u krijuan dhe përpunuan 13.100 materiale audiovizuale me 24 terabajt të dhëna në tri gjuhët zyrtare të Gjykatës.

Në seancat hibride u përfshinë pjesëmarrës të pranishëm në sallën e gjyqit dhe pjesëmarrës nga distanca duke përdorur pajisje të sigurta për videolidhje të cilat ishin vendosur ose në instalime të lëvizshme për videokonferenca, ose në instalime fikse në vende në distancë. Krahas aktiviteteve në sallën e gjyqit, NJTI-ja ofroi mbështetje teknike edhe për aktivitete të ndryshme në mjediset e DHSK-së dhe përpunoi materiale audiovizuale pas riklasifikimit të tyre si publike.

Aplikacioni kryesor që përdoret në DHSK është sistemi elektronik i administrimit gjyqësor *Legal Workflow*. Ky sistem përpunon të gjitha vendimet, parashtrimet dhe komunikimet në lidhje me to, përfshirë materialin e nxjerrë. Është në përdorim edhe gjatë seancave

gjyqësore edhe jashtë tyre, si edhe jashtë orarit zyrtar të punës, për të ndihmuar palët të respektojnë afatet e caktuara nga gjykatësi. Transferimi dhe përditësimi i plotë i sistemit *Legal Workflow* përfundoi në prill 2024, duke garantuar që ky version më i ri është i përshtatshëm për periudhën në vijim.

Sektori i Shërbimeve i NJTI-së ofroi mbështetje për rreth 520 përdorues, përfshirë palët në proceset gjyqësore dhe shërbimet mbështetëse gjyqësore në DHSK. Në fillim të vitit 2024, NJTI-ja nisi përdorimin e shërbimeve të ruajtjes digjitale të të dhënave (cloud) për të përmirësuar kontrollin e TI-së dhe të sigurisë informatike.

Sistemi elektronik i administrimit gjyqësor *Legal Workflow* u përditësua plotësisht në vitin 2024.

4.3 Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme

Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme (NJAOSHP) është përgjegjëse për administrimin efikas dhe të efektshëm të mjediseve të DHSK-së dhe ZPS-së, për të siguruar një mjedis pune cilësor për punonjësit dhe vizitorët. Ndër të tjera, ajo ofron shërbime mbështetëse në lidhje me administrimin e pasurive të paluajtshme, mirëmbajtjen e ndërtesave dhe ndërtimet, në konsultim me autoritetet përkatëse të shtetit pritës.

Njësia kryen edhe shërbime si furnizimi i mensës, pritja e vizitorëve dhe pastrimi. Gjithashtu, NJAOSHP-ja administron planifikimin e hapësirave të brendshme, shërbimin e protokollit, postës së rregullt dhe postës së sigurt, transportin dhe mirëmbajtjen e mjeteve transportuese të DHSK-së dhe udhëtimet dhe

logjistikën, për të cilat bashkëpunon me Njësinë e Sigurisë dhe Protokollin.

Njësia bashkëpunon gjithashtu edhe me EULEX-in për administrimin e objekteve të përdorura nga DHSK-ja dhe ZPS-ja në Prishtinë, Kosovë.

Gjatë vitit 2024 u ndërmorën punime madhore ndërtimore në sistemin e instalimit të ujit për të gjithë ndërtesën. Nevoja e kryerjes së këtyre punimeve ishte urgjente dhe ato u nisën dhe u financuan nga Agjencia Qendrore të Pasurive të Paluajtshme të Holandës (RVB). Punimet u kryen gjatë pushimeve dhe fundjavave për të mos penguar punën kryesore të DHSK-së.

Për t'iu përshtatur rregullave të reja të qëndrueshmërisë në Holandë, RVB-ja nisi planifikimin e rinovimeve madhore të mjediseve të DHSK-së, të cilat do të kryhen vitet e ardhshme dhe do të financohen prej RVB-së.

Mjediset e DHSK-së dhe ZPS-së në rrugën Raamweg 47 në Hagë u morën në përdorim në qershor 2019. Për mirëmbajtjen e ndërtesës dhe instalimeve brenda saj dhe si rezultat për parandalimin e defekteve që mund të pengonin operacionet e përditshme, gjatë vitit 2024 u ndërmorën hapa për planifikimin e një numri rinovimesh kapitale gjatë gjysmës së parë të vitit 2025.

NJAOSHP-ja ka vazhduar mbështetjen e punës së DHSK-së nëpërmjet administrimit efikas të mjediseve, duke siguruar ambiente cilësore pune për punonjësit dhe vizitorët.

4.4 Njësia e Sigurisë

Njësia e Sigurisë (NJS) vazhdoi të ofrojë një gamë të gjerë mbështetjeje në fushën e sigurisë për DHSK-në gjatë gjithë vitit 2024. Kjo kërkoj kapacitet të plotë të personelit për kryerjen e detyrave lidhur me proceset gjyqësore dhe veprimtarive të tjera paralel me to.

NJS-ja zgjeroi dhe më tej fushën e veprimit të detyrave të saj në mbështetje të Administratores duke dhënë vlerësime përtej çështjeve tradicionale të sigurisë. Gjithashtu, së bashku me policinë e Kosovës u hartuan dhe zbatuan procedurat përkatëse për monitorimin dhe raportimin e personave që shërbejnë dënime të ndryshuara ose janë nën kufizime juridike në përputhjet me vendimet gjyqësore përkatëse. Njësia i organizoi edhe vizitat nën ruajtje të dy të paraburgosurve në Kosovë dhe me transferimin e tre personave në objektin e paraburgimit të DHSK-së pas arrestimit të tyre në Kosovë.

Njësia ndërmori gjithashtu dhe punime për të thjeshtuar proceset dhe administrimin e informacionit. Si njësi e digjitalizuar krejtësisht, NJS-ja u siguroi që përpunimi i të dhënave të koordinohet me administrimin e brendshëm, në mënyrë që të mbështeten objektivat më të gjera organizative për administrimin dhe ruajtjen e informacioneve.

Gjatë vitit 2024 NJS-ja vazhdoi ruajtjen e marrëdhënieve efikase dhe shkëmbimin e informacionit me partnerët përkatës, në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, duke u siguruar që çështjet e sigurisë mbeteshin prioritet në planifikimet dhe vendimmarrjet më të gjera në nivel strategjik, taktik dhe operativ. Njësia ishte e përditësuar me të gjitha veprimet e mundshme për sigurimin e një mjedisi që mundëson përmbushjen e mandatit të DHSK-së.

Viti 2024 vazhdoi trendin e shërbimeve mbështetëse të plotësuara 100% pa incidente të rënda të sigurisë.

4.5 Njësia e Financave dhe Buxhetit

Njësia e Financave dhe Buxhetit (NJFB) mbështet Administratoren për administrimin financiar të fondeve që i janë akorduar DHSK-së për zbatimin e mandatit të saj, në përputhje me rregullat dhe rregulloret financiare të brendshme dhe parimet e rregulloreve financiare të BE-së.

Gjatë vitit 2024, NJFB-ja vazhdoi të luajë një rol kyç për ciklin financiar, me qëllim miradministrimin financiar të fondeve. Për sa i përket kornizës rregullatore, gjatë këtij viti u zhvilluan dy direktiva administrative dhe një udhëzim operative në lidhje me proceset me ndikim financiar. Gjithashtu, u përditësuan një direktivë administrative dhe tri udhëzime operative në lidhje me proceset me ndikim financiar. Njësia u përfshi edhe në zhvillimin e rregullave të tjera, duke ofruar ekspertizë dhe këshilla gjatë procesit të hartimit të tyre. Për të përforcuar procedurat dhe njohuritë, NJFB-ja organizoi trainime të brendshme me punonjësit për aspektet kyçe të cikleve financiare të DHSK-së dhe ZPS-së.

Aktiviteti kryesor për vitin 2024 ishte administrimi i buxhetit për Kontratën e Gjashtë për Subvencionim të nënshkruar nga Administratorja në emër të DHSK-së dhe ZPS-së, dhe Komisionit Evropian, si donator i subvencionit. NJFB-ja punoi me Komisionin Evropian për pagesën e shpejtë të kështit të dytë, i cili u mor në korrik 2024.

Krahas kësaj, DHSK-ja administroi fonde në përputhje me Kontratën e Pestë për Subvencionim, që u nënshkrua nga Administratorja në emër të DHSK-së dhe ZPS-së, dhe Komisionit Evropian, për periudhën dyvjeçare 15 qershor 2021 – 14 qershor 2023, në shumën prej 103.279.698 euro. Krahas fondeve të akorduara nga BE-ja, DHSK-ja administroi edhe shumën prej 132.300 euro, të akorduar nga qeveria zvicerane për aktivitetet informuese dhe ndërgjegjëse të DHSK-së për vitet 2024 dhe 2025.

Në vitin 2024, NJFB-ja kreu më shumë se 4,500 veprime financiare në kuadër të angazhimeve buxhetore për pagesat. Gjatë vitit 2024, u dorëzua raporti paraprak i Marrëveshjes së Gjashtë për Subvencionim nga BE-ja për periudhën nga 15 qershori 2023 deri më 31 mars 2024, si dhe raporti përfundimtar për Marrëveshjen për Subvencionim nga qeveria zvicerane për aktivitetet informuese dhe ndërgjegjëse të DHSK-së për vitet 2022 dhe 2023.

Gjithashtu, pas mbylljes së marrëveshjes së mëparshme për fondet e pensionit, Bordi i Fondit të Pensioneve vendosi që fondi të administrohet nga DHSK-ja. Praktikohej kjo do të thoshte se NJFB-ja mori përsipër administrimin e fondit të pensioneve nga fundi i vitit 2024. Njësia krijoi një sistem efikas monitorimi dhe mbështetje për vënien funksionale në veprim të fondit. U hartua dhe një kuadër i qëndrueshëm ligjor për t'i dhënë Bordit të Fondit të Pensioneve rol qendror në këshillimin e Administratores, ndërkohë që NJFB-ja raporton çdo muaj për zbatimin e politikës së depozitimit të kontributeve.

Llogaritë financiare të DHSK-së u nënshtrohen rregullisht auditimeve të pavarura dhe verifikimeve të shpenzimeve, të kryera nga auditues të brendshëm dhe të jashtëm, siç kërkohet nga Komisioni Evropian dhe administrimi i brendshëm. Në vitin 2024, auditimet dhe verifikimet e shpenzimeve të kryera nuk konstatuan asnjë parregullsi. NJFB-ja mbajti një bashkëpunim efektiv me Shërbimin e Komisionit Evropian për Instrumente të Politikës së Jashtme (IPJ) me qëllim monitorimin dhe zbatimin me efektivitet të burimeve financiare të DHSK-së.

Deri në fund të vitit 2024 u kryen 20 auditime të jashtme të DHSK-së, të cilat nuk konstatuan asnjë parregullsi.

4.6 Njësia e Prokurimit

Njësia e Prokurimit (NJP) është përgjegjëse për prokurimet e DHSK-së dhe ZPS-së dhe duke siguruar në kohë dhe me çmimin e duhur mallrat, shërbimet apo punimet e nevojshme për përmbushjen e mandatit të Gjykatës.


Prokurimet janë një nga fushat me kornizë rregullatore më të madhe në sektorin publik. Blerjet nga DHSK-ja dhe ZPS-ja janë rregullisht objekt kontrollesh dhe auditimesh të rrepta për të siguruar respektimin e rregullave të BE-së nga DHSK-ja në këtë drejtim.

Në vitin 2024, kjo njësi vazhdoi organizimin e trajnimeve të rregullta për punonjësit për të siguruar që administrimi i kontratave dhe proceset e anketimit të tregut të kryhen në mënyrë të qëndrueshme dhe rigorozë si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit të proceseve të zbatueshme të tenderimit dhe kriteret për furnitorë të ndryshëm në mënyrë që t'u japë mundësinë për të punuar me DHSK-në dhe ZPS-në sa më shumë bizneseve paravësisht nga

vendndodhja e tyre. Nëpërmjet këtyre përpjekjeve dhe mbështetjes së dhënë njësive të ndryshme për administrimin dhe monitorimin e kontratave, njësia siguroi pajtueshmërinë e DHSK-së dhe ZPS-së me praktikën e mira në fushën e prokurimit dhe minimizimin e rrezikut të mospajtueshmërisë me rregullat dhe rregulloret përkatëse të prokurimit dhe me politikën dhe udhëzimet e brendshme.

NJP-ja vazhdoi evidentimin e mundësive për të rritur efikasitetin e shpenzimeve dhe për të bërë prokurime sa më cilësore, përfshirë zbatimin e kontratave kornizë shumëvjeçare sipas mundësisë.

Në vitin 2024, për DHSK-në dhe ZPS-në u lidhën 71 kontrata prokurimi për një sërë mallrash dhe shërbimesh, me një vlerë prej 9,5 milion euro.



AUDITIMI I BRENDSHËM

Audituesja e Brendshme kryen auditime, raporton konstatimet e saj dhe i jep rekomandime Administratores, duke kontribuar në administrimin dhe llogaridhënien institucionale të DHSK-së dhe ZPS-së përmes kryerjes së auditimeve dhe raportimit të konstatimeve dhe rekomandimeve Administratores.

Auditimi i brendshëm bëhet për të ofruar garanci të pavarura se menaxhimi i rrezikut, administrimi dhe kontrolli i brendshëm i një organizate bëhen në mënyrë efektive dhe efikase. Audituesja e brendshme verifikon gjithashtu statusin e zbatimit të rekomandimeve të saj në auditimet vijuese që kryen. Në punën e saj, audituesja u përmbahet standardeve profesionale ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe Rregullores Financiare të BE-së, dhe propozon masa për përmirësimin e administrimit.

Gjatë vitit 2024, Audituesja e Brendshme kreu tetë auditime në bazë të planit vjetor të auditimit. Këto përfshinë verifikimin e kriterëve të shpenzimeve në llogaritë e pagesave, harxhimet në lidhje me shërbimet gjyqësore, kontributet në fondin e pensionit, menaxhimin e aseteve, shpenzimet në lidhje me shërbimet e paraburgimit, harxhimet në lidhje me pushimet e punëtorëve dhe subvencionin i marrë nga Zvicra. Gjithashtu, Auditorja e Brendshme kreu gjithashtu tetë auditime vijuese për të siguruar se veprimet e miratuara nga drejtuesit ishin zbatuar si duhet. Përveç detyrave të auditimit, Audituesja e Brendshme u angazhua edhe në trajnime për stafin kundër mashtrimit.

Misioni i Auditueses së Brendshme është t'i japë Administratores vlerësime të pavarura dhe objektive për përmirësimin e punës së DHSK-së dhe ZPS-së.



INTEGRIMI I PERSPEKTIVËS GJINORE NË DHSK DHE ZPS

Integrimi i Perspektivës Gjinore dhe Trajnimet Kundër Ngacmimeve

Aktualisht, DHSK-ja dhe ZPS-ja janë e vetmja gjykatë e këtij lloji ku të gjitha postet drejtuese mbahen nga gratë. Kryetarja Ekaterina Trendafilova, Administratorja Fidelma Donlon dhe Prokurorja e Specializuar Kimberli Uest janë të vetëdijshme për rëndësinë e përfaqësimit të balancuar gjinor. Drejtueset synojnë të nxisin një kulturë dinjiteti dhe respekti reciprok në organizatë, dhe kanë zbatuar një politikë të tolerancës zero ndaj çdo forme ngacmimi që nga formimi i saj. Ky përkushtim është mishëruar në Strategjinë kundër Ngacmimit të DHSK-ZPS-së të miratuar në vitin 2019, dhe e fuqizuar më tej me Udhëzuesin kundër Ngacmimit në DHSK-ZPS të vitit 2022.

Barazia Gjinore

Ndikimi i përpjekjeve organizative për arritjen e barazisë gjinore në përfaqësim duket në prirjen në rritje të përfaqësimit të grave ndër punonjësit e rinj në DHSK dhe ZPS që prej vitit 2018. Në vitet 2021 dhe 2022 një shifër rekord prej 56 përqind të punonjësve të rinj ishin gra. Megjithë rënien e lehtë të kësaj shifre në 43 përqind në vitin 2023, rritja u rikthye gjatë vitit 2024, kur pjesa e grave ndër punonjësit e rinj në DHSK dhe ZPS ishte 48 përqind.

Në fund të vitit 2024, DHSK-ja dhe ZPS-ja patën një përfaqësim gjinor mjaft të balancuar, duke iu afruar barazisë gjinore. Nga numri i përgjithshëm i punonjësve, 47 përqind ishin gra dhe 53 përqind burra. Nëse analizohet në nivel postesh, raporti gjinor ishte edhe më afër barazisë në nivelet e ekspertëve dhe të drejtuesve, me 51 përqind gra dhe 49 përqind burra.

Barazia e plotë gjinore në përfaqësim për të gjitha nivelet e DHSK-së u arrit përsëri në nëntor 2024. Një arritje e tillë rëndësishme u shënuar për herë të parë në vitin 2022, dhe më pas raporti i punonjësve gra të DHSK-së në krahasim me burrat u ul paksa. Nga fundi i viti 2024, numri i punonjësve gra mbeti i qëndrueshëm në krahasim me një vit më përpara, duke shënuar një rritje prej tre përqind në nivel drejtuesi dhe ekspert, por duke rënë për atë vit me dy përqind në nivel sekretari dhe asistenti. Përqindja e gjithsejtë e grave ndër punonjësit e ZPS-së u rrit me një përqind, duke mbërritur në 45 përqind në fund të vitit. Në ZPS, megjithë rritjen e përfaqësimit të grave në nivel drejtuesi dhe ekspert, për vitin 2024 u shënuar ulje sa i përket punonjësve gra në nivel sekretari dhe asistenti. Në vitet 2022 dhe 2023, ZPS-ja kishte arritur barazinë gjinore mes punonjësve në nivel sekretari dhe asistenti.

**Balanca e përfaqësimit gjinor
31 dhjetor 2024**

	Të gjitha pozicionet		Nivel drejtuesi dhe eksperti		Nivel sekretari dhe asistenti	
	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
DHSK-ZPS	47%	53%	51%	49%	40%	60%
DHSK	49%	51%	57%	43%	40%	60%
ZPS	45%	55%	44%	56%	40%	60%

Që drejtuesve t'u mundësohet të monitorojnë përparimin në arritjen dhe ruajtjen e barazisë gjinore, ato marrin rregullisht të dhëna të klasifikuara sipas gjinisë prej Njesisë së Burimeve Njerëzore (NJBNU).



Takim për rishikimin e aktiviteteve për barazi gjinore

Trajnimet e posaçme kundër ngacmimeve

Në pajtim me angazhimin e drejtuesve për një mjedis pune të sigurt dhe gjithëpërfshirës dhe pa asnjë formë ngacmimi, deri në fund të vitit 2024, sesionet trajnuese mbi Parandalimin e Ngacmimeve Psikologjike dhe Seksuale i ndoqën 91 përqind e punonjësve. Gjithashtu, gjatë vitit 2024 u organizuan sesione të detyrueshme trajnuese për drejtuesit në lidhje me “Si të trajtohen pretendimet për ngacmime në një mjedis mbështetës”, ku u arrit një pjesëmarrje prej 85 përqind. Këto janë trajnime plotësuese të trajnimeve të tjera për drejtuesit mbi temat e drejtimit dhe administrimit, si pjesë e përgjegjësi të përgjithshme në lidhje me parandalimin e ngacmimeve.

Të tilla trajnime të posaçme për drejtuesit e nivelit të parë dhe punonjësit u mbështetën në punën e bërë gjatë vitit 2023 me planin e veprimtarive të brendshme ndërgjegjësuere, të zhvilluar për të theksuar parimin se përgjegjësia për parandalimin e ngacmimeve është e përbashkët. Bashkë me krijimin dhe shpërndarjen e infografikës dhe pllakateve ku jepet një pasqyrë e kuadrit të DHSK-së dhe ZPS-së për parandalim, raportim dhe reagim ndaj incidenteve të ngacmimit, gjatë vitit 2023 u zhvilluan një seri trajnimesh mbi elementet e reja në Udhëzuesin kundër Ngacmimit për punonjësit, praktikantët dhe kontraktorët. Trajnimet për Udhëzuesin u ndoqën nga 95 përqind e punonjësve.


Strukturat mbështetëse dhe raportimet e rregullta

Punonjësit e DHSK-së dhe ZPS-së vazhduan të kishin qasje në shërbimet e psikologut dhe të këshilluesit për mirëqenien, të cilët ofrojnë udhëzime dhe ndihmë për punonjësit, praktikantët dhe kontraktorët mbi trajtimin e pretendimeve për ngacmime dhe për rrugët zyrtare dhe jozyrtare të trajtimit të rasteve të tillave me anë të Udhëzuesit kundër Ngacmimit. Gjithashtu, një ndërmjetësues i jashtëm mund të përdoret si palë e tretë e pavarur gjatë proceseve jozyrtare të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në rast se kërkohet një shërbim i tillë që palët të arrijnë një zgjidhje miqësore.


Këshilluesi për mirëqenien i DHSK-ZPS-së mbledhi gjithashtu të dhëna statistikore anonime mbi pretendimet e rasteve të ngacmimit, të cilat iu dhanë Administratores në mënyrë konfidenciale nëpërmjet Njesisë së Burimeve Njerëzore (NJBNI). Gjatë vitit 2024, këshilluesi për mirëqenien raportoi një rritje të qartë të ndërgjegjësimit mbi kuadrin kundër ngacmimeve në DHSK dhe ZPS. Të dhëna statistikore anonime NJBNI-së i kanë dhënë edhe drejtuesit dhe ndërmjetësuesit e jashtëm, për numrin e rasteve të ngacmimeve të pretenduara të trajtuara nëpërmjet proceseve jozyrtare, dhe mbi suksesin apo jo të këtyre rasteve.

Balanca e përfaqësimit gjinor në DHSK dhe ZPS


31 dhjetor 2024



Balanca gjinore DHSK



Balanca gjinore ZPS



DHSK

NË NIVEL DREJTUESISH DHE EKSPTËSH

43%

MESHKUJ

57%

FEMRA

NË NIVEL SEKRETARI DHE ASISTENTI

60%

MESHKUJ

40%

FEMRA

ZPS

NË NIVEL DREJTUESISH DHE EKSPTËSH

56%

MESHKUJ

44%

FEMRA

NË NIVEL SEKRETARI DHE ASISTENTI

60%

MESHKUJ

40%

FEMRA

Personi i kontaktit për Çështjet Gjinore

Prania e personit të kontaktit për çështjet gjinore është shprehje e përkushtimit të përgjithshëm të drejtuesve të lartë për zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të një mjedisi pune gjithëpërfshirës.

Gjatë vitit 2024, personi i kontaktit për çështjet gjinore organizoi festimin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Tema e vitit 2024 për Ditën Ndërkombëtare të Gruas ishte “Frymëzo Gjithëpërfshirjen” dhe personi i kontaktit për çështjet gjinore i dërgoi mesazhe të përditshme punonjësve të DHSK/ZPS-së gjatë javës

para Ditës Ndërkombëtare të Gruas, me artikuj interesantë dhe mënyrat me të cilat punonjësit mund të përfshinin njëri-tjetrin në vendin e punës nëpërmjet gjeesteve të vogla të mirësisë. Punonjës të DHSK-së dhe ZPS-së u mbledhën për të festuar dhe nderuar gratë që punojnë në këto institucione, me ç’rast Kryetarja, Administratorja, Prokurorja e Specializuar, një pjesëtare e ekipeve të Mbrojtjes dhe personi i kontaktit për çështjet gjinore folën për Ditën Ndërkombëtare të Gruas.



Prokurorja e Specializuar, Administratorja dhe personi i kontaktit për çështjet gjinore në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, 8 mars 2024



Kryetarja dhe personi i kontaktit për çështjet gjinore në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, 8 mars 2024



Në bashkëpunim me Njësinë për Informim dhe Komunikim me Publikun u dizenuan stema ngjitëse (stickers), të cilat u shpërndanë me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas.



Ende na duhet t'i luajmë malet nga vendi. Por hapat e vegjël kanë prapë peshë. Gjestet e vogla të mirësisë, të inkurajimit, kanë peshë. Të pyesësh kolegun për mendimin e vet, të ftosh dikë për kafe në kafeteri, të ndalosh tek dikush për ta pyetur nëse ka nevojë për ndihmë me ndonjë detyrë, apo edhe të dëgjosh i përkushtuar dikë që propozon një ide apo qasje të re – të tilla gjëra kanë peshë.

Personi i kontaktit për çështjet gjinore më 8 mars 2024, Dita Ndërkombëtare e Gruas.

Mali lëviz pasi kemi marrë me ndërgjegje një vendim për të marrë një gur a guriçkë për ta çuar një hap përpara. Së bashku, secili prej nesh mund të bëjë një gjest të vogël, dhe së bashku, secili nga këto gjeste do të lëvizë malin drejt barazisë dhe do të ndërtojë ekipe gjithëpërfshirëse dhe me diversitet dhe do të sigurojë një gjykatë gjithëpërfshirëse dhe me diversitet.

Në qershor 2024, personi i kontaktit për çështje gjinore mori pjesë në takimin vjetor treditësh të këshilltarëve të Drejtave të Njeriut dhe Çështjeve Gjinore të misionëve të Bashkimit Evropian për Politikë të Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes, të organizuar nga Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm. Gjatë tri ditëve të takimit u bënë prezantime me temë në lidhje me, ndër të tjera, këshilluesit për çështjet gjinore në misionet të ndryshme, si dhe u ofruan seminare për integrimin e perspektivës gjinore.

Më 25 nëntor 2024, personi i kontaktit për çështjet gjinore dërgoi një mesazh për të gjithë punonjësit e DHSK/ZPS-së për të sjellë në vëmendje një fushatë globale të quajtur "16 ditët e aktivizmit për eliminimin e dhunës ndaj grave".

Personi i kontaktit për çështje gjinore administroi gjithashtu faqen e dedikuar në intranet, e cila përditësohet rregullisht me artikuj interesantë dhe lidhje në internet për aktivitete që kanë të bëjnë përgjithësisht me integrimin e perspektivës gjinore, gjithëpërfshirjen dhe diversitetin.

Thyerja e tabusë dhe heshtjes lidhur me dhunën ndaj grave dhe vajzave është thelbësore për përballimin e problemit. Dhuna ndaj grave dhe vajzave nuk është një problem privat. Nuk është problem grash. Është problem për të gjithë shoqërinë, problem që duhet të na shqetësojë të gjithëve dhe për të cilin duhet të ngremë zërin të gjithë.

Së bashku, si në jetën private ashtu edhe në DHSK dhe ZPS, ne rritet vlerat kaq të dashura për ne, tolerancën zero ndaj çdo forme dhune, ndaj çdo forme ngacmimi, dhe garancinë që gratë dhe vajzat të bëjnë përparim në një mjedis të sigurtë dhe gjithëpërfshirës. Sot, dhe në secilën ditë më pas, ne rritet përkushtimin tonë ndaj nxitjes së barazisë, dinjtetit dhe respektit për secilin nga ne.

16 ditë aktivizëm për eliminimin e dhunës ndaj grave,
25 nëntor 2024

AVOKATI I POPULLIT

Avokati i Popullit i DHSK-së

Avokati i Popullit i DHSK-së vepron i pavarur për monitorimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në. Ngritja e Zyrës së Avokatit të Popullit brenda strukturës së DHSK-së dhe ZPS-së është diçka e veçantë, pasi ofron një mekanizëm më shumë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në.

Avokati i Popullit i DHSK-së është Pietro Spera, gjykatës italian, i cili u emërua në këtë post në maj 2018. Mandati dhe funksionet zyrtare të Avokatit të Popullit të DHSK-së përshkruhen hollësisht në amendamentin nr. 24 të Kushtetutës së Kosovës, në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji), Rregulloren e Procedurës dhe të Provave para DHSK-së (Rregullorja) dhe në Rregulloren e Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (DHSGJK).

Në vitin 2024, Zyrës së Avokatit të Popullit iu paraqitën shtatë ankesa. Ka përfunduar procesi për gjashtë prej këtyre ankesave, ndërsa njëra është ende në shqyrtim.

Avokati i Popullit ka refuzuar tre nga gjashtë kërkesat e përfunduara mbi bazën se ankesat nuk janë të argumentuara dhe nuk vërtetojnë që DHSK-ja ose ZPS-ja të kenë qenë të përfshira në ndonjë mënyrë në çështjen për të cilën bëhet ankesa. Ankuesit u njoftuan për rezultatin e ankesave të tyre dhe morën shpjegime të plota për vendimin e Avokatit të Popullit.

Tri ankesat e tjera ishin parashtruar nga katër persona që mbahen të paraburgosur në objektin e paraburgimit të DHSK-së që nga koha e arrestimit të tyre. Për këto ankesa Avokati i Popullit kreu hetimet përkatëse dhe lëshoi raportet përfundimtare që u publikuan në faqen e internetit të DHSK-së.

Në çështjen e parë (ÇËSHTJA-2024-02/01), ankuesit pretendonin se miratimi nga ana e Administratores i Rregullores së rishikuar për Ndihmë Juridike (KSC-BD-25-Rev1) në shkurt 2024 shkelte të drejtat e tyre për mbrojtje të efektshme. Veç kësaj, ankuesit kërkonin që Avokati i Popullit t'ia përcillte DHSGJK-së çështjen e vlefshmërisë kushtetuese të Rregullores për Ndihmë Juridike të ndryshuar.

Avokati i Popullit e refuzoi pikën e parë të ankesës si çështje të lidhur drejtpërdrejt me një proces gjyqësor në vazhdim. Në lidhje me pikën e dytë, Avokati i Popullit konstatoi se kishte kaluar afati prej dy muajsh që kërkohet për t'ia referuar një çështje DHSGJK-së, ndaj nuk mund ta merrte në shqyrtim kërkesën.

Në çështjen e dytë (ÇËSHTJA-2024-02/02), ankuesit parashtruan një kërkesë për rishikimin e një vendimi të mëparshëm të Avokatit të Popullit mbi çështjen (OMB-C-2024-02), me pretendimin se Avokati i Popullit nuk kishte marrë parasysh rregullën 6(4) të Rregullores së DHSGJK-së që e lejon DHSGJK-në, në rrethana të kufizuara, ta zgjasë afatin dy-mujor për paraqitjen e referimeve të bëra nga Avokati i Popullit. Avokati i Popullit theksoi se, pas shqyrtimit që i bëri elementëve proceduralë të referimit të kërkuar dhe duke qenë në dijeni të Rregullores për Ndihmë Juridike që prej miratimit të saj nga Administratorja në vitin 2024, ai nuk shihte asnjë arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit dymujor për t'i kërkuar referim DHSGJK-së. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit e rrëzoi kërkesën për rishikim.

Në çështjen e tretë (ÇËSHTJA-2024-02/03), katër ankuesit parashtronin se mungesa e këshillimit dhe njoftimit përpara miratimit të Rregullores së Ndhmës Juridike të ndryshuar në vitin 2024 përbëjnë dobësi në administrim. Gjithashtu, ato pretendonin se Administratorja nuk u këshillua me Organin Përfaqësues të Pavarur të Mbrojtësve të Specializuar (OPP). Veç kësaj ankuesit parashtronin se ata duhet të kishin qenë pjesë e procesit të këshillimit, sepse ishin, padyshim, palë e interesuar. Së fundi, ankuesit pretendonin se Administratorja nuk e kreu si duhet detyrimin për ta nxjerrë për ta informacionin për procedurën e ndryshimit. Avokati i Popullit e rrëzoi ankesën në tërësinë e saj, sepse konstatoi që, në përputhje me Rregulloren e Ndhmës Juridike, Administratorja nuk ka asnjë detyrim për t'u këshilluar me OPP-në ose me ndonjë palë tjetër të interesuar në rastet e ndryshimeve proprio motu, siç edhe nuk ekziston asnjë e drejtë në përgjithësi për qasje në dokumentet, letrat, të dhënat apo arkivin e krijuar nga Zyra Administrative dhe ZPS-ja, duke qenë se ato nuk konsiderohen dokumentacion publik i Kosovës.

Në vitin 2024, Avokati i Popullit publikoi në faqen e internetit të DHSK-së përmbledhje të të gjitha ankesave që kishte marrë. Veç përmbledhjeve, Avokati i Popullit ka publikuar të plotë në internet Raportimet e lëshuara për të gjitha kërkesat që kanë lidhje me DHSK-në ose me ZPS-në.

Në fillim të vitit 2024, Avokati i Popullit mbylli dy kërkesa që kishin qenë në shqyrtim që në 2023.

Si pjesë e funksionit të tij kontrollues, Avokati i Popullit vazhdoi gjatë gjithë vitit të angazhohej në mënyrë konstruktive me DHSK-në dhe ZPS-në duke synuar sigurimin e respektimit me rigorozitet të standardeve më të larta të të drejtave të njeriut. Veçanërisht, Avokati i Popullit vazhdoi të jetë i angazhuar me Zyrën Administrative dhe Njësinë e Paraburgimit në lidhje me Objektin e Paraburgimit të DHSK-së.

Gjatë vitit 2024, Zyra e Avokatit të Popullit bëri tri vizita për kontroll në objektin paraburgimit të DHSK-së duke synuar përputhjen e plotë me standardet bazë ndërkombëtare për trajtimin e të burgosurve. Kontrollat u kryen në mars, prill dhe shtator 2024.

Në këto kontrolle Avokati i Popullit iu bëri ftesë të paraburgosurve të bisedonin personalisht dhe privatisht me të. Pas kontrolleve, Avokati i Popullit u bind që kushtet e paraburgimit në Objektin e Paraburgimit të DHSK-së vazhdojnë të jenë në përputhje të plotë me standardet bazë ndërkombëtare për trajtimin e të burgosurve.



Avokati i Popullit Pietro Spera

Gjatë gjithë vitit 2024 zyra e Avokatit të Popullit ka vazhduar punën me programin e saj të komunikimit dhe ndërgjegjësimit. Me ndihmën e Njesisë së Informimit dhe Komunikimit Publik të Zyrës Administrative, Zyra e Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në veprimtari të drejtpërdrejta të komunikimit dhe ndërgjegjësimit me përfaqësues të shoqërisë civile në rajon.

Avokati i Popullit nuk sheh se si ndonjëri nga katër ankuesit, ose mbrojtësit e tyre mund të ketë të drejtën që t'i merret mendimi ose të njoftohet për çfarëdolloj ndryshimi që propozohet për Rregulloren për Ndihmë Juridike të vitit 2020, kur dihet që ata i bënë kërkesat për ndihmë juridike në kuadrin e DHSK-së disa muaj pas miratimit të Rregullores së Ndihmës Juridike të ndryshuar. Në këtë vështrim, Avokati i Popullit e rrëzon parashtrimin në emër të katër ankuesve që pretendojnë se kanë qenë "palë qartësisht e interesuar".

Përmbledhje e një prej konstatimeve të Avokatit të Popullit lëshuar pas shqyrtimit të një anese (ÇËSHTJA 2024-02/3), lëshuar më 10 korrik 2024.

ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR

Parathënie

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS), së bashku me Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK), shënoi edhe gjatë vitit të kaluar një sërë arritjesh. ZPS-ja çoi përpara ndjekjen penale të ish-presidentit të Kosovës Hashim Thaçi dhe tre të bashkakuzuarve të tij; përfundoi procedimin penal në një gjyq tjetër të krimeve të luftës që rezultoi në një vendim fajësie; filloi një çështje për një sërë shkeljesh penale kundër administrimit të drejtësisë kundër ish-presidentit Thaçi dhe katër personave të tjerë, tre prej të cilëve ZPS-ja i arrestoi në Kosovë; dhe negocioi tri marrëveshje për pranimin e fajësisë në një çështje të frikësimit të dëshmitarëve. Këto ishin marrëveshjet e para të pranimit të fajësisë në DHSK dhe përbëjnë herën e parë të pranimit të përpjekjeve për të bindur dëshmitarët për të mos dëshmuar nga të akuzuarit në një gjyq për krime lufte në Kosovë.



Kimberli Uest, Prokurore e Specializuar

Është bërë gjithmonë e më e qartë se marrja me kërcënimet e pengimit të drejtësisë dhe frikësimit të dëshmitarëve është themelore për të siguruar integritetin e procedurave gjyqësore në DHSK, dhe sigurimin e përmbushjes së mandatit të ZPS-së. Dëshmia e vërtetë e dëshmitarëve ka rëndësi kritike për proceset gjyqësore. Është tejet e vështirë të sigurohet drejtësi kur presioni nga jashtë bën që dëshmitarët të refuzojnë të vijnë në sallën e gjyqit apo i bind të tërheqin mbrapsht dëshminë në gjyq. Për këto arsye, prioriteti im madhor është që të siguroj që DHSK-ja të shërbejë si një forum i drejtësisë, duke siguruar proces të drejtë për të akuzuarit dhe një mjedis të sigurtë ku dëshmitarët mund të flasin hapur për ato që kanë parë apo përjetuar pa u druajtur nga frikësimi apo hakmarrja.

Me vijimin e punës së mëtejshme, ZPS-ja do të vazhdojë të marrë tejet seriozisht frikësimin, hakmarrjet ndaj dëshmitarëve dhe pengimin e drejtësisë. Gjithashtu, ajo do vazhdojë të ndjekë penalisht këdo që luan një rol në to, përfshirë ata që frikësojnë apo ndërhyjnë tek dëshmitarët apo ofrojnë mbështetje financiare ose tjera për këto shkelje penale.

Dëshiroj të falënderoj të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE), ndër të cilët edhe shtetin pritës, Holandën, si dhe Norvegjinë, Zvicrën dhe Shtetet e Bashkuara si shtete kontribuuese të treta, që vazhduan të ofrojnë burimet dhe mbështetjen e nevojshme në fushën e sundimit të ligjit që kanë bërë të mundur kryerjen e punës sonë. I jam gjithashtu mirënjohës Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe shefit të misionit, gjeneralmajor Xhovani Pjetto Barbano, për ndihmën logjistike dhe operative që i kanë dhënë ZPS-së në Kosovë. Dëshiroj gjithashtu të falënderoj punonjësit e ZPS-së dhe të DHSK-së për angazhimin e përkushtimin e tyre.

Kimberli Uest
Prokurore e Specializuar

Hagë,
Dhjetor 2024

Mandati dhe hetimet e ZPS-së

ZPS-ja u themelua më 1 shtator 2016 mbi bazën e një ndryshimi kushtetues dhe Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 3 gusht 2015.

ZPS-ja trashëgoi personelin dhe mandatin e Task Forcës Hetimore Speciale (TFHS), që u krijua për të hetuar dhe, nëse do të ishte nevoja, të ndiqte penalisht individë për krimet e pretenduara në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të janarit 2011 “Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë”

TFHS-ja ishte një subjekt autonom me seli në Bruksel, juridiksioni dhe autoriteti ligjor i të cilit buronte nga Vendimi i Këshillit të BE-së për themelimin e EULEX-it.

Klint Uilliamson, prokuror nga Shtetet e Bashkuara dhe ish-ambasador i Shteteve të Bashkuara për çështje të krimeve të luftës, drejtoi hetimet e TFHS-së. Në korrik 2014, ai sugjeroi që për hetime të mëtejshme duhej të krijohej një gjykatë.

Gjatë prezantimit të konstatimeve të veta, ambasadori Uilliamson bëri gjithashtu të qartë se çështja që e shqetësonte më së shumti ishte frikësimi i dëshmitarëve në Kosovë, duke shpjeguar se vazhdonin përpjekjet për minimin e hetimit duke ndërhyrë tek dëshmitarët.

ZPS-ja është institucion i pavarur, pavarësia e së cilës garantohet nga Ligji që e krijoi atë. Në këtë mënyrë, ZPS-ja ka detyrimin të veprojë në mënyrë të pavarur prej Dhomave të Specializuara dhe prej të gjithë prokurorëve të tjerë në Kosovë.

Brenda juridiksionit të saj, DHSK-ja ka përparësi ndaj të gjitha gjykatave të tjera në Kosovë. DHSK-ja ose ZPS-ja mund të urdhërojnë transferimin e procedurave që përfshihen në juridiksionin e tyre nga çdo prokuror apo gjykatë tjetër në territorin e Kosovës të Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja, në cilëndo fazë të hetimeve apo të procesit gjyqësor.

Prokurori i Specializuar është i autorizuar të marrë në pyetje viktimat, dëshmitarët dhe të dyshuarit dhe të regjistrojë deklaratat e tyre, të kryejë hetime në vendngjarje, të mbledhë prova, të kryejë ekspertimin e provave të mbledhura dhe të kryejë veprimtari të tjera hetimore të nevojshme; të kërkojë ndihmën e shteteve të treta dhe organizatave ndërkombëtare apo subjekteve të tjera; dhe të marrë masa hetimore sipas Rregullores së Procedurës dhe të Provave.

Dejvid Shvendiman shërbeu si Prokuror i Specializuar nga shtatori 2016 deri në mars 2018, pasi kishte qenë më parë kryeprokuror i TFHS-së që prej qershorit 2015. Xhek Smith pasoi z. Shvendiman në postin e Prokurorit të Specializuar në maj 2018 dhe shërbeu në atë post deri në nëntor 2022. Kimbërli Uest pasoi z. Smith në pozicionin e Prokurorit të Specializuar në tetor 2023.



Ambasadori Klint Uilliamson

Zbatimi i Mandatit

ZPS-ja vazhdoi të përparojë me shpejtësi në vitin 2024. Ajo paraqiti prova gjatë gjithë vitit në gjykimin e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, dhe tre të akuzuarve të tjerë; përfundoi procedimin penal në një gjykim tjetër të krimeve të luftës që rezultoi në vendim fajësie; filloi një çështje për vepër penale kundër administrimit të drejtësisë kundër ish-presidentit Thaçi dhe katër personave të tjerë, tre prej të cilëve ajo i arrestoi në Kosovë; dhe negocioi tri marrëveshje për pranimin e fajësisë në një çështje të frikësimit të dëshmitarëve.

Prokurori k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve

Gjatë vitit 2024, ZPS-ja vazhdoi paraqitjen e provave të saj kundër ish-presidentit të Kosovës Thaçi, Kadri Veselit, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimit dhe, deri në fund të vitit, Trupi Gjykses pranoi dëshmi nga 202 dëshmitarë, përfshirë dëshmitë në sallën e gjyqit të 110 dëshmitarëve.

ZPS-ja thjeshtoi listën e dëshmitarëve dhe njoftoi në një konferencë mbi ecurinë e çështjes më 1 tetor se objektivi për mbylljen e argumenteve të veta në prill të vitit 2025 ishte i arritshëm.

Kundër zotërinjve Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi janë ngritur gjashtë akuza për krime kundër njerëzimit – përndjekje, burgim, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë të personave – dhe katër akuza për krime lufte – arrestim dhe ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme. Gjykimi i tyre filloi më 3 prill 2023.

Sipas aktakuzës, këto krime u kryen më e pakta prej marsit 1998 deri në shtator 1999 në disa vendndodhje në Kosovë, si dhe në Kukës dhe Cahan, në Shqipëri. Pretendohet se këto krime u kryen nga anëtarë të UÇK-së kundër qindra civilëve dhe personave që nuk merrnin pjesë në luftime.

Në aktakuzë pretendohet se zotërinjtë Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi kanë përgjegjësi penale individuale, sipas formave të ndryshme të përgjegjësisë penale, për krime që u kryen në kontekstin e një konflikti të armatosur jondërkombëtar në Kosovë dhe ishin pjesë e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër personave që dyshoheshin se ishin kundër UÇK-së.



Rreshti i parë, nga e majta: prokurorët Xhoshua Hafec adhe Gaja Pergolo;
Rreshti i dytë: Prokurorja e Specializuar Kimbërlit Uest dhe Prokurori Eri Sallivan



Pas dhënies së aktgjykimit në gjykimin e Pjetër Shalës, Prokurorja e Specializuar Kimbërli Uest dha një deklaratë ku nënvizoi rëndësinë e tij për të vënë drejtësi në sistemin gjyqësor të Kosovës. “Arritja e vënies para përgjegjësisë për krime të rënda – përfshirë edhe kundër atyre personave si z. Shala që kishin shmangur më parë për disa vjet juridiksionin e gjykatave të Kosovës – është një hap i rëndësishëm për sundimin e ligjit,” tha znj. Uest.

Prokurorja e Specializuar përkujtoi viktimat e z. Shala. “Dita e sotme është gjithashtu një ditë kur ne kujtojmë dhe përulemi para viktimave të krimeve të z. Shala, që ishin kryesisht shqiptarë të Kosovës, dhe atyre familjeve që kanë pritur për një çerek shekulli që i akuzuari të vihet para përgjegjësisë,” tha ajo.

ZPS-ja arrestoi zotërinjtë Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi dhe DHSK-ja i transferoi në objektin e paraburgimit në Hagë më 4 dhe 5 nëntor 2020.

Më 17 dhjetor 2021, ZPS-ja e dorëzoi dosjen e saj paraprake dhe versionin e përditësuar të saj më 24 shkurt 2022. ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e ndryshuar më tej më 30 shtator 2022.

Pas pretendimeve se tre prej të akuzuarve kishin zbuluar informacion konfidencial dhe, në rastin e z. Thaçi, ishin përpjekur të ndikonin në dëshminë e dëshmitarëve të ardhshëm, ZPS-ja kërkoi një numër masash për kufizimin e kontakteve dhe komunikimeve të tre prej të akuzuarve – Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit – në objektin e paraburgimit të DHSK-së. Një pjesë e këtyre masave u miratuan nga Trupi Gjykues më 1 dhjetor 2023 dhe mbetën në fuqi gjatë vitit 2024.

Gjatë vitit 2024, në këtë çështje ZPS-ja bëri 384 parashtrime.

Prokurori kundër Pjetër Shalës

ZPS-ja përfundoi procedimin penal ndaj Pjetër Shalës, i cili më 16 korrik 2024 u shpall fajtor për tri akuza për krime lufte – ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje të paligjshme – dhe u dënua me 18 vjet burgim.

Z. Shala e apeloj vendimin.

Krimet e z. Shala u kryen përafërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, kundër personave që u mbajtën të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës, Shqipëri.

Trupi Gjykues konstatoi në aktgjykimin e tij se të paktën 18 persona ishin mbajtur në kushte çnjerëzore e degraduese dhe i ishin nënshtruar keqtrajtimit psikologjik e fizik, dhe një nga viktimat ishte vrarë.

Në mesin e provave të parashtruara gjatë gjyqit kishte deklarata në të cilat z. Shala pranonte praninë e tij në fabrikën e metalit në Kukës gjatë periudhës së aktakuzës dhe keqtrajtimin e të burgosurve.

ZPS-ja filloi paraqitjen e provave kundër Pjetër Shalës më 21 shkurt 2023 dhe përfundoi paraqitjen e provave më 6 korrik 2023, ku dëshmuan dhjetë dëshmitarë në sallën e gjyqit. Paraqitja e provave nga Mbrojtja filloi më 20 shtator 2023.

Z. Shala u arrestua më 16 mars 2021 në Belgjikë dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së më 15 prill 2021. Ai pati paraqitjen e parë më 19 prill 2021. ZPS-ja dorëzoi dosjen e saj paraprake më 28 janar 2022 dhe versionin publik të redaktuar të saj më 14 prill 2023.

ZPS-ja bëri 49 parashtrime në këtë çështje gjatë vitit 2024.

Përgjigja e Prokurores së Specializuar ndaj marrëveshjeve për pranimin e fajësisë në çështjen Januzi dhe të tjerët



Duke reaguar ndaj marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, Prokurorja e Specializuar Kimbërli Uest lëshoi një deklaratë ku shpjegoi rëndësinë e tyre.

“Është dëshmi e fuqisë së hetimeve tona në lidhje me frikësimin dhe pengimin e drejtësisë që mundësoi zyrën të përmbyllin këto marrëveshje,” tha Prokurorja e Specializuar. “E bëme këtë pas shqyrtimit të kujdesshëm, ku u morën parasysh, midis të tjerash, rëndësia e pranimeve të përgjegjësisë në këtë kontekst, përfitimet nga arritja e përmbylljes së shpejt në mënyrë të drejtë, dhe mendimet e viktimave.”

Ajo gjithashtu u zotua të vazhdojë hetimet në lidhje me pengimin e drejtësisë për të siguruar integritetin e procedurave në DHSK. “ZPS-ja do të vazhdojë të ndjekë të gjitha ata që përpiqen të ndërhyjnë në administrimin e drejtësisë dhe të angazhohet për viktimat dhe dëshmitarët në Kosovë,” znj. Uest tha.

Prokurori k. Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës

ZPS-ja negocioi marrëveshjet e pranimit të fajësisë me Sabit Januzin, Ismet Bahtijarin dhe Haxhi Shalën, nëpërmjet të cilave të tre të akuzuarit pranuan fajësinë për një akuzë për frikësim dhe një akuzë për pengim.

Këto ishin marrëveshjet e para të pranimit të fajësisë në DHSK dhe hera e parë që pranohen vullnetarisht tentimet për të bindur dëshmitarët që të mos dëshmojnë në një çështje të krimeve të luftës në Kosovë.

Në marrëveshje të ndara për pranimin e fajësisë, të tre të akuzuarit pranuan fajin përpara fillimit të gjyqit të tyre. Zotrinjtë Januzi dhe Shala pranuan fajësinë në sallën e gjyqit më 18 dhjetor 2024; z. Bahtijari pranoi fajësinë në sallën e gjyqit më 19 dhjetor 2024.

Me pranimin e fajësisë, zotërinjtë Shala, Januzi dhe Bahtijari pranuan se ishin pjesë e një grupi që tentoi të nxiste një person që të mos jepte dëshmi para Dhomave të Specializuara përmes premtimit të një përfitimi.

ZPS-ja arrestoi z. Januzi dhe z. Bahtijari në Kosovë më 5 tetor 2023. Ata u transferuan në objektin e paraburgimit të DHSK-së më 6 tetor 2023.

ZPS-ja arrestoi z. Shala në Kosovë më 11 dhjetor 2023. Ai u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së më 12 dhjetor 2023.

ZPS-ja dorëzoi kërkesën për bashkimin e çështjeve kundër Januzit dhe Bahtijarit me çështjen kundër Haxhi Shalës më 13 dhjetor 2023, e cila u miratua nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 8 shkurt 2024.

ZPS-ja dorëzoi dosjen e vet paraprake më 16 shkurt 2024. Të tre ekipet e Mbrotjtjes dorëzuan versionet përfundimtare të dosjeve të tyre paraprake më 2 shtator 2024. Gjykimi ishte caktuar të fillonte më 14 nëntor 2024.

ZPS-ja bëri 233 parashtime në këtë çështje gjatë vitit 2024.

Prokurori k. Hashim Thaçi dhe të tjerëve (administrimi i drejtësisë)

Më 5 dhjetor 2024, ZPS-ja e akuzoi ish-presidentin e Kosovës Hashim Thaçi për shkelje vepra kundër administrimit të drejtësisë bashkë me katër pesona të tjerë: Bashkim Smakajn, Isni Kilajn, Fadil Fazliun dhe Hajredin Kuçin. Aktakuza u konfirmua nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake të DHSK-së më 29 nëntor 2024.

Z. Thaçi iu dorëzua fletarrestimi në objektin e paraburgimit të DHSK-së dhe përballet me tri akuza për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, katër akuza për shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe katër akuza për mosbindje ndaj gjykatës. Ai bëri paraqitjen e parë publike më 8 dhjetor 2024.

ZPS-ja arrestoi zotërinjtë Smakaj, Kilaj dhe Fazliu në bazë të aktakuzës së konfirmuar dhe fletarrestimeve më vete të lëshuara nga Gjykatësi i Gjykatës Paraprake. Ata u transferuan në objektin e paraburgimit të DHSK-së më 6 dhjetor 2024.

Zotërinjtë Smakaj, Kilaj dhe Fazliu përballen secili me një akuzë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe një akuzë për mosbindje ndaj gjykatës. Zotërinjtë Smakaj dhe Fazliu bënë paraqitjen e parë publike më 8 dhjetor 2024. Z. Kilaj bëri paraqitjen e parë publike më 9 dhjetor 2024.

ZPS-ja i paraqiti aktakuzën z. Kuçi në Kosovë dhe e thirri të paraqitej para Gjykatësit të Gjykatës Paraprake në DHSK. Z. Kuçi përballet me dy akuza për mosbindje ndaj gjykatës dhe bëri paraqitjen e parë më 9 dhjetor 2024.

ZPS-ja bëri 48 parashtime në këtë çështje gjatë vitit 2024.

Raportimet diplomatike



Gjatë vitit 2024, ZPS-ja mori pjesë në disa takime diplomatike për përditësimin e shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuuese mbi punën e ZPS-së, sfidat me të cilat përballej ZPS-ja dhe mënyrat me të cilat mund të ndihmonte bashkësia ndërkombëtare në përshejtimin e punës së ZPS-së.

Së bashku me kryetaren e DHSK-së Ekaterina Trendafilova dhe Administratoren Fidelma Donlon, Prokurorja e Specializuar Kimbërli Uest foli para diplomatëve të shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuuese në dhjetor 2024 në Hagë.

Zëvendësprokurori i Specializuar Vard Ferdinandse foli para këshilltarëve ligjorë të vendeve anëtare të BE-së në Hagë në shtator 2024.

Debati Juridik në Çështjet Nasim Haradinaj dhe Salih Mustafa

Në vitin ZPS-ja u përfshi edhe në debate lidhur me çështjet e Nasim Haradinajt dhe Salih Mustafës. Z. Haradinaj, i cili u dënua në maj të vitit 2022 për frikësim gjatë procedurës penale, shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, pretendonte shkelje të të drejtave dhe lirive të tij në kontekstin e procesit penal kundër tij.

Më 31 maj 2024, Paneli i Dhomës Kushtetuese e shpalli një pjesë të ankesës së tij të papranueshme dhe hodhi poshtë pjesën tjetër, duke konstatuar se nuk kishte pasur asnjë shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ose të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore. Më parë, Paneli i Gjykatës Kushtetuese kishte rrëzuar kërkesën e z. Haradinaj për mbrojtje të ligshmërisë.

Z. Mustafa, i cili në dhjetor 2022 ishte dënuar për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme të cilat u lanë në fuqi nga Apeli, kundërshtoi aktgjykimin e Dhomës së Apelit me një kërkesë për mbrojtje të ligshmërisë drejtuar Panelit të Gjykatës Supreme të DHSK-së.

Pas udhëzimeve dhe anulimit të dënimit të mëparshëm nga Paneli i Gjykatës Supreme, më 10 shtator 2024, Paneli i Gjykatës së Apelit uli dënimin e z. Mustafa në 15 vjet burg. Fillimisht, dënimi ishte 26 vjet, i cili u zvogëlua nga apeli në 22 vjet.

ZPS-ja bëri 10 parashtrime në këtë çështje gjatë vitit 2024.



Vizitat në Kosovë



Prokurorja e Specializuar Kimbërli Uest dhe Zëvendësprokurori Vard Ferdinandse vizituan Kosovën në tetor 2024 për një sërë takimesh me shefat e misionëve të organizatave ndërkombëtare dhe për t'i informuar ambasadorët e shteteve anëtare të BE-së dhe të shteteve të treta kontribuuese në Kosovë.

Prokurorja e Specializuar gjithashtu vizitoi Kosovën në dhjetor 2024 për takime të mëtejshme.

Procedurat kundër Dritan Goxhaj

Prokuroria e Shqipërisë apeloj në emër të ZPS-së vendimin e Gjykatës së Apelit të Shqipërisë që refuzoi ekstradimin e shtetasit shqiptar Dritan Goxhaj në DHSK. Apelimi u rrëzua nga Gjykata e Lartë në 9 korrik 2024.

Më 31 korrik 2023, pas fletarrestimit të kërkuar nga ZPS-ja dhe të lëshuar nga një gjykatës i DHSK-së, autoritetet shqiptare arrestuan z. Dritan Goxhaj në Tiranë dhe një gjykatë në Tiranë miratoi ekstradimin e tij më 18 shtator. Megjithatë, z. Goxhaj e apeloj vendimin dhe u lirua nga Gjykata e Apelit më 10 tetor 2023.

ZPS-ja kërkoi arrestimin dhe ekstradimin e z. Dritan Goxhaj në lidhje me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, përfshirë frikësim dhe pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare.



Prokurori Mat Holling

Puna hetuese e mëtejshme

ZPS-ja vazhdoi hetimet lidhur me pengimin e drejtësisë gjatë vitit 2024 për të ruajtur integritetin e procedurave në DHSK, me qëllim të ndjekjes penale të të gjithë atyre që frikësojnë ose ndërhyjnë ndaj dëshmitarëve ose i japin mbështetje financiare ose mbështetje tjetër për këto vepra penale.

ZPS-ja gjithashtu vazhdoi me marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe të dyshuarve, me rishikimin e provave dokumentare dhe përgatitjen e tyre për nxjerrje.



Rreshti i parë nga e majta: prokurorët Filipo De Miniçis, Gaja Pergolo dhe Eva Uajler
Rreshti i dytë: Prokurorja e Specializuar Kimbërli Uest

Kuadri Udhëheqës i Prokurorisë



Kimbërlë Uest | Prokurore e Specializuar

ZPS-ja drejtohet nga një ekip prokurorësh të lartë, që të gjithë me shumë përvojë në juridiksionet e shteteve të tyre dhe në gjykata ndërkombëtare.

Prokurorja e Specializuar është Kimbërlë Uest (Kimberly West), e cila ka qenë më parë prokurore federale e SHBA-së me përvojë të gjerë në fushën e hetimeve penale në nivel të brendshëm dhe ndërkombëtar.

Znj. Uest iu bashkua ZPS-së në tetor 2023 nga Firma Ligjore Eshcroft (Ashcroft Law Firm) në Boston, Masaçusets (Massachusetts), ku ishte partnere që nga viti 2019 dhe ku u përqendrua kryesisht në mbrojtje të çështjeve penale të lidhura me krimin ekonomik. Para se të merrte detyrën në këtë firmë, znj. Uest punoi si prokurore për më shumë se dy dekada në role në nivel lokal, shtetëror, federal dhe ndërkombëtar.

Znj. Uest ka qenë gjithashtu shefe e Byrosë së Krimeve në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm të Masaçusetsit në periudhën nga viti 2015 deri në 2019. Në këtë rol, ajo mbikëqyri një ekip prej 120 profesionistësh të ngarkuar me hetimin dhe ndjekjen penale të një game të gjerë veprash penale në fushën e mashtrimeve financiare, korrupsionit publik, trafikut të drogës, lojërave të fatit dhe trafikimit të qenieve njerëzore; në mbrojtjen e vendimeve të fajësisë në apel; dhe në ndihmën për viktimat dhe dëshmitarët.

Znj. Uest mori detyrën në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm pas punës në Zyrën e Prokurorit të SHBA-së, Distrikti i Masaçusetsit, ku shërbeu për dy vjet si ndihmëspkurore federale në Njësinë për Mashtrimet në Kujdesin Shëndetësor dhe gjashtë vjet në Njësinë e Sigurisë Kombëtare. Znj. Uest iu bashkua Njësisë së Sigurisë Kombëtare pas sulmit terrorist të 11 shtatorit 2001 në Qendrën Tregtare Botërore dhe në Pentagon.

Për pesë vjet, në periudhën nga viti 2008 deri në 2013, znj. Uest shërbeu si prokurore në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë në Hagë, ku ishte anëtare e ekipit që ndoqi penalisht Radovan Karaxhiqin për rolin e tij në gjenocidin në Srebrenicë. Ajo ishte gjithashtu në ekipin e prokurorëve në çështjen gjyqësore Përliq dhe të tjerët, që u përqendrua në krimet e kryera në Mostar dhe shkatërrimin e Urës së Vjetër.

Znj. Uest ka diplomë Juris Doctor (Doktor në Drejtësi) nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Safolkut (Suffolk), Masaçusets, dhe u bë anëtare e Dhomës së Avokatëve në Masaçusets. Ajo ka kryer studimet universitare në Kolegjin e Bostonit, Masaçusets.



Vard Ferdinandse

Zëvendësprokuror i Specializuar

Zëvendësprokurori i Specializuar është **Vard Ferdinandse** (Ward Ferdinandusse), i cili iu bashkua ZPS-së në vitin 2020 si shef i Njesisë së Hetimeve. Z. Ferdinandse, me shtetësi holandeze, përfundoi studimet universitare në drejtësi dhe mbrojti doktoraturën në Universitetin e Amsterdemit në fushën e zbatimit të së drejtës penale ndërkombëtare në gjykatat vendore. Ai ka botuar një numër të madh shkrimesh mbi të drejtën penale vendore dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, ai ishte lektor i së drejtës penale ndërkombëtare dhe evropiane në Universitetin e Groningenit, me fokus mbi bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale.

Gjatë punës si prokuror në Zyrën e Prokurorisë Publike në Rotterdam, z. Ferdinandse u angazhua në procedime penale, procedura ekstradimi dhe hetime të krimeve ndërkombëtare si gjenocidi, krimet e luftës, tortura, pirateria dhe terrorizmi. Para se t'i bashkohej ZPS-së, ai ishte kryeprokuror në gjykimin e çështjes lidhur me rrëzimin e avionit MH17.



Xhoshua Hafec

Shef i Njesisë së Hetimeve

Xhoshua Hafec (Joshua Hafetz) është shef i Njesisë së Hetimeve. Është shtetas i ShBA-ve dhe kreu studimet universitare për drejtësi në Shkollën e Ligjit të Jeillit. Para se t'i bashkohej ZPS-së, z. Hafec shërbeu për një dekadë si prokuror federal në Zyrat e Prokurorit në Njuark, Nju Xhersi dhe Bruklin, Nju Jork, ku u përqëndrua në krimet e dhunshme dhe çështjet e kundërterrorizmit.

Më herët gjatë karrierës, z. Hafec punoi për një firmë ligjore të njohur në qytetin e Nju Jorkut pas praktikës tek një gjykatës në distriktin jugor të shtetit të Nju Jorkut. Para diplomimit për drejtësi, z. Hafec ka punuar për katër vjet në qytetin e Nju Jorkut si hetues.





Alan Tiger
Prokuror i lartë

ZPS-ja ka tre prokurorë të lartë, Alan Tigerin, Kler Losonin dhe Natan Kuikun.

Alan Tiger (Alan Tieger) është prokuror i lartë i ZPS-së, me shtetësi amerikane dhe përvojë të gjerë në SHBA dhe në TPNJ. Z. Tiger punoi si në gjykimin e parë në TPNJ – në çështjen e Dushko Tadiqit – edhe në gjykimin e fundit në atë institucion – në çështjen e Ratko Mlladiqit. Ai ishte prokuror i lartë edhe në gjykimet e Ante Gotovinës, Radovan Karaxhiqit, Momçillo Krajishnikut, Darko Mërgjës dhe Biljana Pllavshiqit.

Nga viti 1987 deri në vitin 1994, z. Tiger ishte prokuror federal në Seksionin Penal të Drejtorisë së të Drejtave Civile në Departamentin e Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara, ku procedoi çështje të dhunës racore dhe brutalitetit policor në të gjithë vendin, përfshirë çështjen e Rodni Kingut (Rodney King).

Ai u diplomua në Universitetin e Kalifornisë në Los Anxheles ndërsa studimet e doktoraturës në fushën e drejtësisë i përfundoi në Universitetin Santa Klara.



Kler Loson
Prokurore e lartë

Kler Loson (Clare Lawson) me shtetësi irlandeze, u diplomua në Kolegjin e Universitetit të Dublinit. Gjatë kohës së studimeve ajo kreu një vit specializim në fushën e së drejtës ndërkombëtare në Universitetin e Melburnit dhe mori titullin e magjistris të drejtësisë nga Universiteti Kolumbia. Përpara se të fillonte punën në ZPS, znj. Loson punoi si juriste në Seksionin Gjyqësor të GJPN-së, në Zyrën e Prokurorisë së TPNJ-së, si këshilltare për të drejtat e njeriut në qeverinë irlandeze, dhe si avokate në një firmë të njohur avokatie në Irlandë.

Znj. Loson ka punuar në një numër çështjesh penale ndërkombëtare, ndër të cilat, çështje që kanë të bëjnë me Republikën e Afrikës Qendrore, Republikën Demokratike të Kongos, Kenian, dhe ish-Jugosllavinë. Ajo gjithashtu ka udhëhequr negociata për të drejtat e njeriut në emër të BE-së në OKB.



Natan Kuik
Prokuror i lartë

Natan Kuik (Nathan Quick) është shtetas amerikan me përvojë në shumë tribunalë ndërkombëtarë dhe hibride, por dhe si avokat në Shtetet e Bashkuara, ka punuar për ZPS-në që prej vitit 2018. Para se t'i bashkohej ZPS-së. z. Kuik ka punuar për Mekanizmin e OKB-së për tribunalët penale ndërkombëtarë në Hagë, Gjykatën Penale Ndërkombëtare në Hagë, programin e ndihmës teknike të Kombeve të Bashkuara për Gjykimet e Kmerëve të Kuq në Pnom Pen, Kamboxhia; dhe në Gjykatën Speciale për Sierra Leonen.

Z. Kuik është diplomuar për drejtësi nga Fakulteti Juridik i Universitetit Kejs Uestern (Case Western) në Klivlend të shtetit të Ohajos dhe u bë anëtar i Dhomës së Avokatëve në shtetin e Illinoisit.

Ekipet e Prokurorisë

Ekipi në gjykimin e Shalës

Ekipi i prokurorisë në gjykimin e Pjetër Shalës përbëhet nga Filipo De Miniçis, Gaja Pergolo dhe Eva Uajllër. Z. De Miniçis është ndihmësprokuror italian që më parë ka punuar në TNPJ, në zyrën e ekipeve të përbashkëta të gjykatësve hetues në Dhomat e Jashtëzakonshme të Gjykatave të Kamboxhias, si edhe Zyrën e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në Korenë e Jugut. Znj. Pergolo është ndihmësprokurore italiane, e arsimuar në Itali dhe Britaninë e Madhe, e cila më parë ka punuar në Zyrën e Prokurorit të Mekanizmit Përmblyës Ndërkombëtar të Tribunalëve Penalë në

Hagë; në kuadër të programit të ndihmës teknike të Kombeve të Bashkuara për Gjykimet e Kmerëve të Kuq në Pnom Pen, Kamboxhia; dhe në Gjykatën Speciale për Sierra Leonen. Ajo gjithashtu ka punuar për REDRESS, një organizatë joqeveritare që kryen procedime penale në emër të të mbijetuarve të torturës. Znj. Uajllër është ndihmësprokurore zvicerane, e cila më parë ka punuar si avokate në një nga firmat kryesore të avokatisë në fushën e padive penale, hetimit dhe të drejtës penale në Zvicër, dhe si gjykatëse hetuese ushtarake dhe prokurore ushtarake.



Filipo De Miniçis
Ndhmësprokuror



Gaja Pergolo
Ndhmësprokuror



Eva Uajllër
Ndhmësprokuror

Ekipi në çështjen Haxhi Shala, Januzi dhe Bahtijari

Ekipi i Prokurorisë në çështjen kundër Haxhi Shalës, Sabit Januzit dhe Ismet Bahtijarit përbëhet nga Xhoshua Hafec, Taznin Shahabudin (Taznin Shahabudin) dhe Xhon Devani (John Devaney). Z. Hafec është shefi i hetimeve të ZPS-së dhe më parë ka qenë prokuror federal në Shtetet e Bashkuara ku u përqëndrua në krimet e dhunshme dhe çështjet e kundërterrorizmit. Zonja Shahabudin është prokurore

amerikane dhe kryer studimet në SHBA dhe Britani të Madhe, e cila më parë ka punuar si prokurore federale në Shtetet e Bashkuara. Z. Devani është ndihmësprokuror amerikan i cili ka kryer studimet në Shtetet e Bashkuara dhe Holandë, dhe ka punuar më parë për Zyrën e Prokurorit të GJPN-së dhe në fushën e të drejtës penale në Shtetet e Bashkuara.



Xhoshua Hafec
Shefi i hetimeve



Taznin Shahabudin
Prokurore



Xhon Devani
Prokurore

Ekipi në çështjen Taçi dhe të tjerët (Administrimi i drejtësisë)

Ekipi i Prokurorisë në çështjen Taçi dhe të tjerët, administrimi i drejtësisë, përbehej nga Xhoshua Hafec, Gaja Pergolo dhe Niko Barlink. Z. Hafec është shef i Njesisë së Hetimeve dhe më parë shërbeu për një dekadë si prokuror federal në Shtetet e Bashkuara, ku u përqëndrua në krimet e dhunshme dhe çështjet e kundërterrorizmit. Znj. Pergolo është ndihmësprokurore italiane, e arsimuar në Itali dhe Britaninë e Madhe, e cila më parë ka punuar në Zyrën e Prokurorisë Publike në Melburn, në zyrën e ekipeve të përbashkëta të gjykatësve hetues në Dhomat e Jashtëzakonshme të Gjykatave të Kamboxhias dhe në Dhomën Gjyqësore të Tribunalit Special për Libanin.

Gjykimet e Kmerëve të Kuq në Phnom Penh, Kamboxhia; dhe në Gjykatën Speciale për Sierra Leonen. Ajo gjithashtu ka punuar për REDRESS, një organizatë joqeveritare që kryen procedime penale në emër të të mbijetuarve të torturës. Z. Barlink është ndihmësprokuror gjerman, i cili ka kryer arsimimin e trajnimit ligjor në Australi. Ai ka punuar më parë në Zyrën e Prokurorisë Publike në Melburn, në zyrën e ekipeve të përbashkëta të gjykatësve hetues në Dhomat e Jashtëzakonshme të Gjykatave të Kamboxhias dhe në Dhomën Gjyqësore të Tribunalit Special për Libanin.



Xhoshua Hafec
Shef i hetimeve



Gaja Pergolo
Ndihmësprokurore



Niko Barlink
Ndihmësprokuror

Personeli

Personeli i ZPS-së përbëhet nga prokurorë, këshilltarë juridikë, specialistë të sigurisë, hetues, analistë, specialistë për sigurinë e dëshmitarëve dhe personeli mbështetës. Në fund të vitit 2024, personeli i ZPS-së përbëhej nga 78 punonjës me 24 shtetësi të ndryshme nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuuese. Nga këta 78 punonjës, 44 ishin meshkuj dhe 34 femra.







KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS &
SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE

DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS RAPORTI I VITIT 2024

Botuar dhe shpërndarë nga:
Dhomat e Specializuara të Kosovës

Botuar në tri gjuhë:
Shqipe, serbishte dhe anglishte

Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit të DHSK-së:
www.scp-ks.org

Për pyetje nga mediat në lidhje me Dhomat e Specializuara të Kosovës:
mediaKSC@scp-ks.org

Për pyetje nga mediat në lidhje me Zyrën e Prokurorit të Specializuar:
spokespersonSPO@scp-ks.org

Paraqitja grafike:
Wim Jansen Design
www.wimjansendesign.nl

Shtypur nga:
Quantes Grafimedia
www.quantes.nl

**E drejta e autorit © 2025 Dhomat e Specializuara dhe Zyra e
Prokurorit të Specializuar të Kosovës.**

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

The background is a solid dark blue. Faintly visible in the background is a stylized illustration of a person's face, looking slightly to the right. The face is composed of simple, rounded shapes. To the right of the face, there is a large, detailed gear or cogwheel, showing its teeth and central hub. The overall aesthetic is clean and modern, with a focus on geometric and organic forms.

www.scp-ks.org